



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**PROJEKTLIGJ PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE<sup>1</sup>**

**DRAFT LAW ON ACCESS TO PUBLIC DOCUMENTS<sup>2</sup>**

**NACRT ZAKONA O PRISTUPU JAVNIM DOKUMENTIMA<sup>3</sup>**

---

<sup>1</sup> Projektligji për qasje në dokumente publike, është miratuar në mbledhjen e 50 të - Qeverisë së Republikës së Kosovës me vendim nr.05/50 me datë 05.06.2018;

<sup>2</sup> Draft law on access to public documents, was approved in the 50-meeting of the Government of Republic of Kosova with the decision no. 05/50 dt. 05.06.2018;

<sup>3</sup> Nacrt zakon o pristupu javnim dokumentima, usvojenje na 50-oj sednici Vlade Republike Kosova, odlukom br.05/50 od 05.06.2018

|   |  |  |
|---|--|--|
| <p>Kuvendi i Republikës së Kosovës,</p> <p>Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,</p> <p>Miraton:</p> <p><b>LIGJ PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE</b></p> <p><b>KAPITULLI I<br/>DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 1<br/>Qëllimi</b></p> <p>1. Ky ligj garanton të drejtën e secilit person, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje në dokumente publike, të prodhuara, pranuar, mbajtura apo kontrolluara nga institucionet publike, si dhe të drejtën për ripërdorimin e dokumenteve dhe informatave të sektorit publik.</p> <p>2. Ky ligj përcakton kufizimet dhe përjashtimet në të drejtën për qasje në dokumente dhe informata publike vetëm për</p> | <p>Assembly of the Republic of Kosovo,</p> <p>Pursuant to Article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo,</p> <p>Approves:</p> <p><b>LAW ON ACCESS TO PUBLIC DOCUMENTS</b></p> <p><b>CHAPTER I<br/>GENERAL PROVISIONS</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 1<br/>Purpose</b></p> <p>1. This Law shall guarantee the right of every person, without discrimination on any grounds, to access public documents produced, received, maintained or controlled by public institutions, as well as the right to re-use the public sector documents and information.</p> <p>2. This Law sets the restrictions and exceptions to the right of access to public documents and information only for</p> | <p>Skupština Republike Kosovo,</p> <p>Na osnovu člana 65 (1) Ustava Republike Kosovo,</p> <p>Usvaja:</p> <p><b>ZAKON O PRISTUPU JAVNIM DOKUMENTIMA</b></p> <p><b>POGLAVLJE I<br/>OPŠTE ODREDBE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 1<br/>Cilj</b></p> <p>1. Ovaj zakon garantuje svakom licu pravo, bez diskriminacije po bilo kojoj osnovi, na pristup javnim dokumentima i informacijama, proizvedenim, primljenim, održanim ili kontrolisanim od strane javnih institucija, kao i pravo na ponovnu upotrebu dokumenata i informacija javnog sektora.</p> <p>2. Ovaj zakon određuje ograničenja i izuzetke prava na pristup javnim dokumentima i informacijama samo u</p> |
|---|--|--|

|   |   |  |
|---|---|--|
| <p>qëllime legjitime dhe deri në shkallën që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike për arritjen e atij qëllimi pa çënuar thelbin e të drejtës që garantohet me këtë ligj.</p> <p>3. Ky ligj përcakton detyrimet e institucioneve publike për të publikuar dokumentet dhe informatat publike në mënyrë proaktive dhe për të siguruar hapjen e të dhënave publike, si dhe përcakton procedurën për qasje përmes kërkesës së personave.</p> <p>4. Ky ligj është në përputhje me Direktivën 2013/37/EU të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 26 qershor 2017, mbi ripërdorimin e informatave të sektorit publik.</p> | <p>legitimate purposes and to the extent necessary in a democratic society for achieving that purpose without prejudice to the essence of the right guaranteed by this Law.</p> <p>3. This Law sets the public institutions' obligations to proactively publish the public documents and information and to ensure the disclosure of public data, and establishes the procedure for access upon the person's request.</p> <p>4. This Law is in accordance with Directive 2013/37/EU of the European Parliament and of the Council of 26 June 2017 on the re-use of public sector information.</p> | <p>zakonitim svrhama i do mere u kojoj su neophodna u jednom demokratskom društvu radi postizanja tog cilja, bez narušavanja suštine prava zagaranovanog ovim zakonom.</p> <p>3. Ovaj zakon određuje obaveze javnih institucija za objavljivanje javnih dokumenata i informacija na proaktivan način i za obezbeđivanje otvaranja javnih dokumenata, kao i određuje proceduru pristupa po zahtevu lica.</p> <p>4. Ovaj zakon je u skladu sa Direktivom 2013/37/EU Evropskog Parlamenta i Saveta, od dana 26. jun 2017. godine, o ponovnoj upotrebi informacija javnog sektora.</p> |
| <p style="text-align: center;"><b>Neni 2</b><br/><b>Fushëveprimi</b></p> <p>1. Ky ligj zbatohet për të gjitha dokumentet publike që prodhohen, pranohen, mbahen, apo kontrollohen nga institucionet publike, përveç nëse dhënia e dokumentit publik të kërkuar është jashtë fushëveprimit të detyrës publike të institucionit publik.</p> <p>2. Paragrafi 1 nuk përbën obligim për institucionet publike që të krijojnë apo përshtasin dokumente publike apo të ofrojnë</p>   | <p style="text-align: center;"><b>Article 2</b><br/><b>Scope</b></p> <p>1. This Law shall apply to all public documents produced, received, maintained, or controlled by public institutions; unless the supply of the requested public document falls outside of the scope of the public task of the public institution.</p> <p>2. Paragraph 1 does not constitute an obligation for the public institution to create or adapt public documents or provide</p>   | <p style="text-align: center;"><b>Član 2</b><br/><b>Delokrug</b></p> <p>1. Ovaj zakon se primenjuje na sve javne dokumente proizvedene, primljene, održavane, ili kontrolisane od strane javnih institucija, osim ako je davanje traženog javnog dokumenta van delokruga javne obaveze javne ustanove.</p> <p>2. Stav 1 neće predstavljati obavezu javnih institucija da stvaraju ili prilagode javna dokumenta ili da pruže sažete informacije</p>  |

|   |   |   |
|---|---|---|
| <p>përmbledhje të informatave kur një gjë e tillë do të përfshinte përpjekje joproporcionale, që shkon përtej një operimi të thjeshtë. Mbi këtë bazë, institucionet publike nuk mund të obligohen që të vazhdojnë prodhimin dhe ruajtjen e një lloji të caktuar të dokumentit publik me qëllim të ripërdorimit të tij nga një person apo institucionet publike.</p> | <p>summaries of information where this would involve disproportionate effort, going beyond a simple operation. On the same basis, public institutions cannot be required to continue the production and storage of a certain type of public document with a view to the re-use of the same by a person or public institution.</p> | <p>kada bi to podrazumevalo nesrazmerno zalaganje, koje ide izvan jednostavnog postupka. Na toj osnovi, javne institucije ne mogu biti u obavezi da nastave proizvodnju i očuvanje određene vrste javnog dokumenta sa ciljem njegovog ponovnog korišćenja od strane lica ili javnih institucija</p> |
| <p>3. E drejta për qasje në dokumente realizohet në pajtim me këtë ligj, pa paragjykuar dispozitat e ligjeve, si dhe të instrumentet ligjore ndërkombëtare, të cilat njohin të drejta më të gjera për qasjen në dokumente publike.</p>  | <p>3.The right to access documents shall be exercised pursuant to this Law, without prejudice to provisions of laws and the international legal instruments providing for more rights to access public documents.</p>   | <p>3. Pravo na pristup javnim dokumentima se realizuje u skladu sa ovim zakonom, bez prejudiciranja zakonskih odredaba, kao i međunarodnim pravnim instrumentima, koji priznaju šira prava za pristup javnim dokumentima.</p>   |
| <p>4. Ky ligj nuk cenon të drejtën për qasje në dokumente publike që mbahen nga institucionet publike, e të cilat mund të rrjedhin nga instrumentet ligjore ndërkombëtare apo aktet e institucioneve të cilat i zbatojnë ato.</p>   | <p>4. This Law shall be without prejudice to the right to access public documents maintained by public institutions, which can derive from the international legal instruments or from the acts of institutions enforcing them.</p>   | <p>4. Ovaj zakon ne narušava pravo na pristup javnim dokumentima koji se održavaju od strane institucija, koja mogu da proizilaze iz međunarodnih pravnih instrumenata ili akata institucija koja ih primenjuju.</p>  |
| <p>5. Kërkesa dhe qasja në dokumente dhe informata të klasifikuara, bëhet në përputhje me ligjin përkatës për klasifikimin e informacionit.</p>   | <p>5. The application and access to classified documents and information shall be made in accordance with the relevant law on classification of information.</p>  | <p>5. Zahtev i pristup klasifikovanim dokumentima i informacijama se vrši u skladu sa relevantnim zakonom o klasifikaciji informacija.</p>  |
| <p>6. Dispozitat e këtij ligji nuk aplikohen:<br/>6.1. për informatat e klasifikuara të</p>   | <p>6. The provisions of this Law shall not apply:<br/>6.1. to information classified, produced</p>  | <p>6. Odredbe ovog zakona se ne primenjuju:<br/>6.1 za klasifikovane informacije koje</p>   |

|   |  |  |
|---|--|--|
| <p>prodhuara dhe mbajtura nga organizatat ndërkombëtare apo përfaqësitë e shteteve të tjera; dhe</p> <p>6.2. informatat e klasifikuara nga institucionet publike, që kanë prejardhje apo janë shkëmbyer në bazë të një kornize të bashkëpunimit me organizata ndërkombëtare apo shtete të tjera.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 3</b><br/><b>Përkufizimet</b></p> <p>1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:</p> <p>1.1. Institucionet Publike – Nënkupton institucionet dhe organet e pushtetit shtetëror në vijim:</p> <p>1.1.1. Qeverinë dhe administratën në nivelin qendror dhe lokal;</p> <p>1.1.2. Personat fizikë apo juridikë, nëse ushtrojnë autoritet apo kompetenca administrative dhe vetëm në lidhje me to, kryejnë detyra publike, apo operojnë me fonde publike sipas ligjeve të Republikës së Kosovës;</p> <p>1.1.3. Institucionet ligjvënëse lidhur</p> | <p>and maintained by international organizations or missions of other states; and</p> <p>6.2. to the information classified by public institutions, originating or exchanged on the basis of a framework of cooperation with international organizations or other states.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 3</b><br/><b>Definitions</b></p> <p>1. Terms used in this Law shall have the following meaning:</p> <p>1.1. Public Institutions – shall mean the following state institutions and bodies:</p> <p>1.1.1. Government and administration at central and local level;</p> <p>1.1.2. Natural or legal persons, if and only in relation to the extent they exercise administrative authority or powers, exercise public functions or operate by public funds in accordance with laws of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.1.3. Law-making institutions in</p> | <p>su proizvedene i održane od strane međunarodnih organizacija ili predstavništava drugih zemalja.</p> <p>6.2 klasifikovane informacije javnih institucija, koje potiču ili su razmenjene na osnovu jednog okvira saradnje sa međunarodnim organizacijama ili drugim državama.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 3</b><br/><b>Definicije</b></p> <p>1. Izrazi upotrebljeni u ovom zakonu imaju sledeće značenje:</p> <p>1.1. Javne institucije – Podrazumeva sledeće institucije i organe državnih vlasti:</p> <p>1.1.1. Vladu i upravne organe na centralnom i lokalnom nivou;</p> <p>1.1.2. Fizička ili pravna lica, pod uslovom da vrše administrativni autoritet ili nadležnost, i samo u vezi sa njima vrše javne dužnosti, ili posluju sa javnim fondovima u skladu sa zakonima Republike Kosovo;</p> <p>1.1.3. Zakonodavne institucije u vezi</p> |
|---|--|--|

|  |   |  |
|--|---|--|
| <p>me aktivitetet e tyre;</p> <p>1.1.4. Institucionet e prokurorisë lidhur me aktivitetet e tyre;</p> <p>1.1.5. Institucionet gjyqësore lidhur me aktivitetet e tyre;</p> <p>1.1.6. Institucionet e pavarura të përcaktuara në ose të themeluara sipas Kapitullit XII të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;</p> <p>1.1.7. Subjektet politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, të cilat financohen me fonde publike; dhe</p> <p>1.1.8. Kompanitë publike në të cilat shteti zotëron shumicën e aksioneve, apo të cilat ushtrojnë një funksion publik, sipas paragrafit 1.1.3 të këtij neni.</p> <p>1.2. Dokument Publik – Nënkupton çdo përfaqësim të akteve, fakteve apo informatave dhe çdo përmbledhje të atyre akteve, fakteve apo informatave në formë elektronike apo me zë, formë të shtypur, në incizime vizuale apo audiovizuale të prodhuara apo mbajtura nga institucioni publik.</p> | <p>relation to their other activities;</p> <p>1.1.4. Prosecution institutions in relation to their activities;</p> <p>1.1.5. Judicial institutions in relation to their activities;</p> <p>1.1.6. Independent institutions listed in, or established under Chapter XII of Constitution of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.1.7. Political entities represented in the Assembly of Kosovo, which are funded by public funds; and</p> <p>1.1.8. Public companies in which the state owns a majority of shares or which exercise a public function under paragraph 1.1.3 of this Article.</p> <p>1.2. Public Document – Shall mean, any representation of acts, facts or information and any summary of such acts, facts or information on paper, stored in electronic form or on sound, in print, in visual or audiovisual recordings produced by or in position of a public institution.</p> | <p>sa njihovim aktivnostima;</p> <p>1.1.4. Institucije tužilaštva u vezi sa njihovim aktivnostima;</p> <p>1.1.5. Institucije pravosuđa u vezi sa njihovim aktivnostima;</p> <p>1.1.6. Nezavisne institucije koje su određene ili osnovane u skladu sa Poglavljem XII Ustava Republike Kosovo;</p> <p>1.1.7. Politički subjekti koji su zastupljeni u Skupštini Kosova, koji se finansiraju iz javnih fondova; i</p> <p>1.1.8. Javne kompanije u kojima država poseduje većinu akcija, ili koje vrše javnu funkciju, u skladu sa stavom 1.1.3 ovog člana.</p> <p>1.2. Javni dokument – Znači svako predstavljanje akata, činjenica ili informacija i svaki pregled tih akata, činjenica ili informacija elektronskim putem ili glasom, štampane, vizuelne ili audiovizuelne snimke proizvedene ili koje drže javne institucije.</p> |
|--|---|--|

|   |   |  |
|---|---|--|
| <p>1.3. Informacion – Nënkupton, por nuk kufizohet në, të dhëna, fotografi, vizatime, video, film, raport, akt, tabelë, projekte, drafte ose shtesa të tjera, të cilat prodhohen, pranohen, mbahen ose kontrollohen nga institucionet publike, pavarësisht nëse janë të përfshira në ndonjë dokument, si dhe pavarësisht burimit, kohës së krijimit, vendit të depozitimit ose ruajtjes, mediumin ose formën në të cilën gjendet, emrit ose institucionit publik në emër të cilit është krijuar ose çfarëdo karakteristike tjetër të informacionit.</p> <p>1.4. Të dhëna të hapura - Nënkupton të dhënat e prodhuara, pranuar, mbajtura apo kontrolluara nga institucionet publike, të cilat mund të përdoren lirisht, të modifikohen dhe shpërndahen nga çdo person, me kusht që të mbesin të hapura dhe t'i atribuohen burimit.</p> <p>1.5. Publikim – Nënkupton vënien në dispozicion në një formë përgjithësisht të qasshme për publikun dhe që përfshinë shtypin, transmetimin dhe format elektronike të përhapjes së informacionit.</p> <p>1.6. Person – Nënkupton çdo person fizik apo juridik, pa dallim mbi çfarëdo baze, i cili kërkon qasje në dokumente dhe</p> | <p>1.3. Information – Shall mean, but is not limited to, data, pictures, drawings, videos, films, reports, acts, tables, projects, drafts or other annexes produced, received, maintained or controlled by public institutions, whether or not included in any public document, and regardless of the source, the time of creation, the place of deposit or storage, the media or the form in which it is stored, the name or public institution on behalf of which it is created or any other characteristics of the information.</p> <p>1.4. Open Data - shall mean the data produced, received, maintained or controlled by public institutions, which can be freely used, modified and distributed by any person, provided that they remain open and attributable to the source.</p> <p>1.5. Publication – shall mean making available in a form generally accessible to the public and which includes print, broadcast and electronic forms of dissemination of information.</p> <p>1.6. Person – shall mean any natural or legal person, without discrimination on any grounds, asking for access to public</p> | <p>1.3. Informacija – Podrazumeva, ali se ne ograničava, na podatke, fotografije, crteže, video zapise, filmove, izveštaje, akte, tabele, projekte, nacрте ili druge dodatke, koji se proizvode, održavaju ili kontrolišu od strane javnih institucija, bez obzira da li su obuhvaćene u nekom dokumentu, kao i bez obzira na izvor, vreme stvaranja, mesto deponovanja ili čuvanja, medijum ili oblik u kojem se nalazi, naziv ili instituciju u čije ime je kreirana ili bilo koju drugu karakteristiku informacije.</p> <p>1.4. Otvoreni podaci - Podrazumeva proizvedene, primljene, održavane ili kontrolisane podatke od strane javnih institucija, koja se mogu slobodno koristiti, modifikovati i distribuirati od strane svakog lica, pod uslovom da ostanu otvoreni i da se pripisuju izvoru.</p> <p>1.5. Objavlјivanje – Podrazumeva stavljanje na raspolaganje u opšte javnom dostupnom obliku i koji obuhvata štampu, emitovanje i elektronske formate širenja informacije.</p> <p>1.6. Lice – Podrazumeva svako fizičko ili pravno lice, bez razlike po bilo kojoj osnovi, koje zahteva pristup javnim</p> |
|---|---|--|

|  |   |  |
|--|---|--|
| <p>informata publike sipas këtij ligji.</p> <p>1.7. Ripërdorimi i Dokumenteve Publike – Ripërdorimi nga çdo person i dokumenteve publike për qëllime komerciale dhe jokomerciale tjera nga qëllimi fillestar për të cilat janë prodhuar dokumentet ose informatat publike.</p> <p>1.8. Testi i Dëmit dhe i Interesit Publik – Testi ligjor që e vlerëson dëmin që do t'i shkaktohej interesit të mbrojtur kundrejt interesit publik për publikim, që duhet të bëjnë institucionet publike para marrjes së vendimit për refuzim të publikimit të dokumenteve publike me vetiniciativë, si dhe para marrjes së vendimit për refuzimin e kërkesave për qasje në dokumente publike, i cili duhet të përfshihet në arsyetim të vendimit mbi refuzim.</p> <p>1.9. Agjencia – Nënkupton Agjencinë për Informim dhe Privatësi, të themeluar në bazë të ligjit të veçantë për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p>1.10. Komisioneri – Organ i pavarur, i emëruar nga Kuvendi i Kosovës në kuadër të Agjencisë, i cili është përgjegjës për</p> | <p>documents and information under this Law.</p> <p>1.7. Re-use of Public Documents – shall mean the re-use by any person of the public documents for commercial and non-commercial purposes, other than the original purpose for which the public documents or information were produced.</p> <p>1.8. Damage and Public Interest Test – shall mean the legal test weighing the damage it would cause to a protected interest against the public interest for publication, to be carried out by public institutions before making a decision for rejecting to publish public documents on their own initiative and before making a decision to reject the requests for access to public documents, which shall be included in the justification of the decision on rejection.</p> <p>1.9. Agency – shall mean the Information and Privacy Agency, established under a special law on personal data protection.</p> <p>1.10. Commissioner – shall mean an independent body within the Agency, appointed by the Assembly of Kosovo,</p> | <p>dokumentima i informacijama prema ovom zakonu.</p> <p>1.7. Ponovna upotreba dokumenata i informacija javnog sektora – Ponovna upotreba dokumenata i informacija javnog sektora, od strane bilo kojeg lica, za komercijalne i nekomercijalne svrhe, iz prvobitne svrhe za koju su dokumenti i javne informacije proizvedene.</p> <p>1.8. Test štete (ispitivanje i štete) i javnog interesa - pravni test koji procenjuje štetu koja je prouzrokovana javnom interesu naspram javnog interesa za publikaciju, koje bi trebalo da izvrše javne institucije pre donošenja odluke za odbijanje javnih dokumenata na sopstvenu inicijativu, kao i pre donošenja odluke o odbijanju zahteva za pristup javnim dokumentima, koji bi trebalo da bude uključen u obrazloženju odluke o odbijanju.</p> <p>1.9. Agencija – Podrazumeva Agenciju za informisanje i privatnost, uspostavljenu u skladu sa posebnim zakonom za zaštitu ličnih podataka.</p> <p>1.10. Poverenik – Nezavisan organ, imenovan od strane Skupštine Kosova u okviru Agencije, koji je odgovoran za</p> |
|--|---|--|



|  |  |   |
|--|--|---|
| <p>sigurimin e zbatimit të këtij ligji dhe për ndërmarrjen dhe shqiptimin e masave të parashikuara me këtë ligj për zbatimin dhe promovimin e të njëjtit.</p> <p>1.11. Zyrtar Përgjegjës – Nënkupton zyrtarin më të lartë udhëheqës të institucionit publik sikurse është përcaktuar me ligj,—i cili është përgjegjës për vendimmarrje në kuadër të një institucioni publik.</p> <p>1.12. Zyrtar Përgjegjës për Qasje në Dokumente Publike – Zyrtar administrativ në kuadër të institucionit publik, i caktuar për pranimin dhe regjistrimin e kërkesave të pranuar për qasje në dokumente zyrtare, për kryerjen e shqyrtimit fillestar të këtyre kërkesave, për ruajtjen dhe mbajtjen e evidencave të këtyre kërkesave dhe për raportimin rreth këtyre kërkesave.</p> <p>1.13. Gjykata – Gjykata kompetente e përcaktuar me ligjin mbi gjykatat kompetente për gjykimin e çështjeve administrative.</p> | <p>which is responsible for ensuring the implementation of this Law and for undertaking and imposing the measures provided by this Law for the implementation and promotion of the same.</p> <p>1.11. Responsible Official – shall mean the senior public official of the public institution, as defined by the Law, who is responsible for decision-making within a public institution.</p> <p>1.12. Official Responsible for Access to Public Documents – Administrative official within the public institution, assigned to receive, register, perform the initial review, store, keep records of and report on the requests received to access public documents.</p> <p>1.13. Court – The competent court determined by the law on courts competent to adjudicate on administrative matters.</p> | <p>osiguranje sprovodenja ovog zakona i za preduzimanje i izricanje mera koje su predvidene ovim zakonom, radi sprovodenja i promovisanja istog.</p> <p>1.11. Odgovorni službenik – Podrazumeva najvišeg rukovodećeg službenika javne institucije, kao što je određeno zakonom, koji je odgovoran za donošenje odluka u okviru jedne javne institucije.</p> <p>1.12. Odgovorni službenik za pristup javnim dokumentima – Administrativni službenik u okviru javne institucije, određen za prijem, registrovanje primljenih zahteva za pristup zvaničnim dokumentima, za obavljanje početnog razmatranja tih zahteva, za održavanje i vođenje evidencije tih zahteva i izveštavanje o tim zahtevima.</p> <p>1.13. Sud – Nadležni sud određen važećim zakonom o sudovima za rešavanje administrativnih slučajeva.</p> |
|--|--|---|

| <p style="text-align: center;"><b>Neni 4</b><br/><b>Parimet Themelore të së Drejtës në Qasje në Dokumente dhe Informata Publike</b></p>   | <p style="text-align: center;"><b>Article 4</b><br/><b>Basic Principles on the Right to Access Public Documents and Information</b></p>  | <p style="text-align: center;"><b>Član 4</b><br/><b>Opšti osnovni principi prava na pristup javnim dokumentima i informacijama</b></p>   |
|---|--|--|
| <p>1. E drejta për qasje në dokumente dhe informata publike e secilit person, si dhe garantimi dhe përmbushja e kësaj të drejte nga ana e institucioneve publike përbën një prej themeleve të institucioneve demokratike dhe transparente.</p> <p>2. Qasja në dokumente dhe informata publike bëhet përmes publikimit proaktiv nga ana e institucioneve publike të dokumenteve dhe informatave publike dhe përmes kërkesës së personit për qasje në dokumente publike.</p> <p>3. Secili person ka të drejtë të ripërdorë dokumentet publike sipas kushteve dhe kufizimeve të përcaktuara me këtë ligj.</p> <p>4. Hapja e të dhënave dhe transparenca në sektorin publik shërben për llogaridhënie ndaj publikut, për zhvillimin dhe avancimin shoqëror, ekonomik dhe demokratik.</p> <p>5. E drejta për qasje në dokumente dhe informacione publike i takon secilit person në</p> | <p>1. Every person's right to access public documents and information, and the guarantee and fulfilment of this right by public institutions, constitutes one of the foundations of democratic and transparent institutions.</p> <p>2. Access to public documents and information shall be done through proactive publication of public documents and information by public institutions and upon a person's request for access of public documents.</p> <p>3. Each person shall have the right to re-use public documents under the conditions and restrictions set forth in this Law.</p> <p>4. The disclosure of data and transparency in the public sector serve to the public accountability in terms of social, economic and democratic development and advancement.</p> <p>5. The right to access public documents and information belongs to all persons <del>people</del></p> | <p>1. Pravo na pristup javnim dokumentima i informacijama svakog lica, kao i garantovanje i ispunjavanje ovog prava od strane javnih institucija predstavlja jedan od temelja demokratskih i transparentnim institucija.</p> <p>2. Pristup javnim dokumentima i informacijama se vrši kroz proaktivno objavljivanje od strane javnih institucija javnih dokumenata i informacija i kroz zahtev svakog lica za pristup javnim dokumentima.</p> <p>3. Svako lice ima pravo da ponovo koristi dokumentaciju i informacije javnog sektora prema uslovima i ograničenjima određenim ovim zakonom.</p> <p>4. Otvaranje podataka i transparentnost u javnom sektoru služi da bi bili odgovori prema javnosti, za društveni, ekonomski i demokratski razvoj.</p> <p>5. Pravo na pristup javnim dokumentima i institucijama pripada svakom licu na jednak i</p> |

|  |  |   |
|--|--|---|
| <p>mënyrë të njëjtë dhe të barabartë. Institucionet publike nuk favorizojnë askë në ushtrimin e të drejtës për qasje në dokumente dhe informacione publike në krahasim me të tjerët.</p> <p>6. Kufizimi i të drejtës për qasje në dokumente publike bëhet vetëm në rastet e kufizuara dhe specifike të përcaktuara me këtë ligj.</p> <p><b>KAPITULLI II<br/>PUBLIKIMI I DOKUMENTEVE DHE<br/>INFORMACIONEVE PUBLIKE</b></p> <p><b>Neni 5<br/>Publikimi me Iniciativë të Institucioneve<br/>Publike</b></p> <p>1. Institucionet publike detyrohen të publikojnë në mënyrë proaktive çdo dokument publik të prodhuar, të pranuar, të mbajtur apo të kontrolluar, në formë elektronike, përmes publikimit në ueb faqen zyrtare të institucioneve publike, pavarësisht kërkesës së personit për qasje.</p> <p>2. Ueb faqet e institucioneve publike duhet të përmbajnë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:</p> <p>2.1. Misionin dhe funksionet e institucionit publik, duke përfshirë edhe ato</p> | <p>equally. Public institutions shall not favour one person in exercising the right to access public documents and information while disfavouing the others.</p> <p>6. Restrictions on the right to access public documents shall be made only in limited and specific cases determined by this Law.</p> <p><b>CHAPTER II<br/>PUBLICATION OF PUBLIC<br/>DOCUMENTS AND INFORMATION</b></p> <p><b>Article 5<br/>Publication upon Public Institutions<br/>Initiative</b></p> <p>1. Public institutions are obliged to proactively publish any public documents produced, received, maintained or controlled in electronic form, through publication on the official website of public institutions, irrespective of a person's request for access.</p> <p>2. Websites of the public institutions shall contain, including but not limited to:</p> <p>2.1. The mission and functions of the public institution, including those of the</p> | <p>ravnopravan način. Javne institucije ne favorizuju nikoga u ostvarivanju prava na pristup javnim dokumentima i informacijama u odnosu na druge.</p> <p>6. Ograničavanje prava na pristup javnim dokumentima i informacijama se vrši samo u ograničenim i specifičnim slučajevima koji su određeni ovim zakonom.</p> <p><b>POGLAVLJE II<br/>OBJAVLJIVANJE JAVNIH<br/>DOKUMENATA I INFORMACIJA</b></p> <p><b>Član 5<br/>Objavljanje na inicijativu javnih<br/>institucija</b></p> <p>1. Javne institucije su dužne da na proaktivan način objavljuju svaki javni dokument koja je proizveden, primljen, vođen ili kontrolisan u elektronskom obliku, kroz objavljanje na službenoj veb stranici javnih institucija, bez obzira na zahtev lica za pristup.</p> <p>2. Veb stranice javnih institucija treba da sadrže, uključujući, ali ne ograničavajući se na:</p> <p>2.1. Misiju i funkcije javne institucije, uključujući i one podređenih jedinica;</p> |
|--|--|---|

|   |   |   |
|---|---|---|
| <p>të njësive në vartësi;</p> <p>2.2. Skemën organizative të institucionit publik, duke përfshirë edhe atë të njësive në vartësi;</p> <p>2.3. Legjislacionin bazë për organizimin, funksionimin dhe funksionet e institucionit përkatës;</p> <p>2.4. Të dhënat e përditshme për veprimtarinë publike të institucionit, aktet ligjore e nënligjore;</p> <p>2.5. Strategjitë dhe dokumentet e tjera të linjëveprimeve të miratuara, në fushën e veprimit dhe funksionet e institucionit publik;</p> <p>2.6. Listën e hollësishme të shërbimeve që ofron institucioni për publikun, si: licenca, leje, autorizime, çertifikata, vërtetime apo shërbime publike të tjera, ku do të përfshihen edhe:</p> <p>2.6.1. Procedurat dhe kushtet e përfitimit të tyre;</p> <p>2.6.2. Dokumentacioni i nevojshëm dhe kostoja për realizimin e shërbimit;</p> <p>2.6.3. Formulari i aplikimit për çdo</p> | <p>subordinated units thereof;</p> <p>2.2.The organizational chart of the public institution, including that of the subordinated units thereof;</p> <p>2.3.The basic legislation on organization, functioning and functions of the institution concerned;</p> <p>2.4.The daily information on public activity of the respective institution, legal acts and sublegal acts;</p> <p>2.5.Other strategies and documents of approved actions in line with the scope and functions of the public institution;</p> <p>2.6.The detailed list of services provided to the public by the institution such as: licenses, permits, authorizations, certificates, confirmations, other public services, including therein:</p> <p>2.6.1. The procedures and conditions for being provided with such services;</p> <p>2.6.2. The necessary documentation and service cost;</p> <p>2.6.3. The application form for each</p> | <p>2.2.Organizacionu shemu javne institucije, uključujući i one podređenih jedinica;</p> <p>2.3.Osnovno zakonodavstvo za organizovanje, funkcionisanje i funkcije relevantne institucije;</p> <p>2.4.Svakodnevne podatke o javnoj delatnosti institucije, zakonske i podzakonske akte;</p> <p>2.5.Strategije i druge dokumente usvojenih linija delovanja, u oblasti delovanja i funkcijama javnih institucija;</p> <p>2.6.Detaljnu listu usluga koje institucija pruža javnosti, kao: licence, dozvole, ovlašćenja, sertifikati, uverenja ili druge javne usluge, gde će se obuhvatiti i:</p> <p>2.6.1. Procedure i uslovi za njihovo dobijanje;</p> <p>2.6.2. Neophodna dokumentacija i troškovi za realizaciju usluge;</p> <p>2.6.3. Formular za apliciranje za bilo</p> |
|---|---|---|

|   |   |  |
|---|---|--|
| <p>shërbim dhe udhëzuesi i plotësimit të tij;</p> <p>2.6.4. Afati i detyrueshëm për të marrë përgjigje për shërbimin e kërkuar;</p> <p>2.6.5. Afati dhe organi ku bëhet ankimi, në rast refuzimi të përgjigjes apo të mosofrimit të shërbimit në afatin e detyrueshëm ligjor.</p> <p>2.7. Secili institucion publik detyrohet të ketë një adresë zyrtare të postës elektronike, posaçërisht për komunikim me publikun dhe të ngarkojë një person për të kontrolluar rregullisht të dhënat e pranuar. I njëjti mund të jetë përgjegjës për rifreskimin, sigurimin e qasjes dhe besueshmërinë e informatave në ueb faqet e institucioneve publike.</p> <p>2.8. Qeveria e Kosovës mund të caktojë, me vendim, përmbajtjen shtesë për ueb faqet e institucioneve publike.</p> | <p>service and guidelines on how to fill it in;</p> <p>2.6.4. The mandatory time limit to receive a reply for the requested service;</p> <p>2.6.5. The time limit and the body where an appeal can be filed in case of refusal to reply or failing to provide a service within the legal mandatory time limit.</p> <p>2.7. Each public institution shall have an official email address designated especially for public communication and shall assign a person to check the information received on regular basis. The same person may be responsible for updating, ensuring access and credibility of information posted on the public institutions' websites.</p> <p>2.8. The Government of Kosovo may determine, by means of a decision, the additional content on the public institutions websites.</p> | <p>koju uslugu i uputstvo za njegovu popunjavanje;</p> <p>2.6.4. Obavezan rok za dobijanje odgovora za traženu uslugu;</p> <p>2.6.5. Rok i organ kod kojeg se podnosi žalba, u slučaju odbijanja odgovora ili nepružanja usluge u obaveznom zakonskom roku.</p> <p>2.7. Svaka javna institucija je obavezna da ima zvaničnu adresu elektronske pošte, posebno za komuniciranje sa javnošću i da zaduži lice da redovno kontroliše primljene podatke. Isti može biti odgovoran za ažuriranje, obezbeđivanje pristupa i pouzdanosti informacija na veb stranicama javnih institucija.</p> <p>2.8. Vlada Kosova može, odlukom, odrediti dodatni sadržaj za veb stranice javnih institucija.</p> |
| <p style="text-align: center;"><b>Neni 6</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Publikimi i Dokumenteve Publike</b></p> <p>1. Institucionet publike detyrohen të publikojnë, në mënyrë proaktive, çdo</p>  | <p style="text-align: center;"><b>Article 6</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Publication of Documents and Information</b></p> <p>1. Public institutions are obliged to proactively publish any public document</p>   | <p style="text-align: center;"><b>Član 6</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Objavlјivanje dokumenata i informacija</b></p> <p>1. Javne institucije su obavezne da objavlјuju, na proaktivan naćin, svaki javni dokument,</p>  |

|   |  |   |
|---|--|---|
| <p>dokument publik, të prodhuar, të pranuar, të mbajtur apo të kontrolluar nga to, menjëherë pasi dokumentet dhe informacionet e tilla të jenë bërë të gatshme për publikim, por jo më larg se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga momenti i bërjes së tyre të qasshme.</p> <p>2.Përfundimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, institucionet publike nuk publikojnë proaktivisht ato dokumente publike, të cilat përmbajnë të dhëna që përbëjnë bazë për refuzimin e qasjes në dokumente publike në bazë të nenit 16 të këtij ligji.</p> <p>3.Me rastin e vendosjes nëse dokumentet publike përmbajnë ndonjërin prej kufizimeve të parapara me nenin 16 të këtij ligji, institucionet publike detyrohen të bëjnë testin e dëmit dhe të interesit publik para vendosjes për mospublikim të dokumenteve të tilla.</p> | <p>produced, received, maintained or controlled by the same, as soon as such documents and information are made available for publication, but not later than fifteen (15) days from the moment they are rendered accessible.</p> <p>2.Exceptionally from paragraph 1 of this Article, public institutions shall not proactively publish public documents containing data that constitute grounds for refusal of access to public documents pursuant to Article 16 of this Law.</p> <p>3.Upon deciding whether the public documents contain any of the restrictions provided for in Article 16 of this Law, public institutions shall perform a damage and public interest test prior to deciding not to publish such documents.</p> | <p>koji je proizveden, primljen vođen ili pod njihovom kontrolom, odmah nakon što slični dokumenti i informacije budu spremni za objavljivanje, najkasnije petnaest (15) dana od trenutka njihove dostupnosti.</p> <p>2.Izuzev stava 1. ovog člana, javne institucije ne objavljuju proaktivno ta javna dokumenta, koja sadrže podatke koji čine osnovu za odbijanje pristupa javnim dokumentima na osnovu člana 16. ovog zakona.</p> <p>3.Prilikom odlučivanja o tome da li javni dokumenti sadrži bilo koje ograničenje predviđeno članom 16. ovog zakona, javne institucije se obavezuju da izvrše ispitivanje štete i javnog interesa pre odlučivanja o neobjavlivanju takvih dokumenata.</p> |
| <p style="text-align: center;"><b>Neni 7</b><br/><b>Format e Publikimit</b></p>   | <p style="text-align: center;"><b>Article 7</b><br/><b>Forms of Publication</b></p>  | <p style="text-align: center;"><b>Član 7</b><br/><b>Oblici objavljivanja</b></p>  |
| <p>1. Dokumentet publike të publikuara nga vetë institucionet publike, bëhen publike në njërin nga format e mëposhtme:</p> <p>1.1. elektronike;</p> <p>1.2. të shtypur;</p> <p>1.3. përmes transmetimit; apo</p>  | <p>1. Public documents published by public institutions shall be made public in one of the following forms:</p> <p>1.1. electronic;</p> <p>1.2. printed;</p> <p>1.3. through broadcasting; or</p>  | <p>1.Javni dokumenti i informacije objavljene od strane samih javnih institucija, postaju javne na jednom od sledećih oblika:</p> <p>1.1. elektronskom;</p> <p>1.2. štampanom;</p> <p>1.3. putem emitovanja; ili</p>  |

|   |  |   |
|---|--|---|
| <p>1.4.në çfarëdo forme tjetër, e cila mundëson qasjen e numrit sa më të madh të publikut.</p> <p>2.Dokumentet publike të publikuara nga vetë institucionet publike, bëhen publike në gjuhët zyrtare të aplikueshme në Republikën e Kosovës, në përputhje me ligjin përkatës mbi përdorimin e gjuhëve.</p> <p><b>KAPITULLI III<br/>PUBLIKIMI I TË DHËNAVE TË HAPURA</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 8<br/>Nocioni dhe Parimet e Hapjes së të Dhënave</b></p> <p>1.Në publikimin e të dhënave të hapura, institucionet publike udhëhiqen nga parimet e mëposhtme:</p> <p>1.1.Të dhënat e hapura publikohen me iniciativë të vetë institucioneve publike, pa kërkesë të palëve të interesuara, në kohë dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse, të saktë dhe me cilësi të lartë.</p> <p>1.2.Të dhënat e hapura publikohen në</p> | <p>1.4. in any other form which allows a larger number of people to access such documents and information.</p> <p>2.Public documents published by public institutions themselves shall be made public in the official languages applicable in the Republic of Kosovo in accordance with the relevant law on the use of languages.</p> <p><b>CHAPTER III<br/>PUBLICATION OF OPEN DATA</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 8<br/>The Notion and Principles of Open Data</b></p> <p>1.When publishing open data, the public institutions shall be guided by the following principles:</p> <p>1.1.Open data shall be published based on the initiative of public institutions themselves, in due time, and in a comprehensive, accurate manner, and with high quality, without a request submitted by the interested parties;</p> <p>1.2.Open data shall be published in a</p> | <p>1.4.u bilo kom drugom obliku, koji omogućava pristup većem broju javnosti.</p> <p>2.Javni dokumenti objavljeni od strane samih javnih institucija, objavljuju se na važećim službenim jezicima u Republici Kosovo, u skladu sa relevantnim zakonom o upotrebi jezika.</p> <p><b>POGLAVLJE III<br/>OBJAVLJIVANJE OTVORENIH<br/>PODATAKA</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 8<br/>Pojam i principi otvaranja podataka</b></p> <p>1.Prilikom objavljivanja otvorenih podataka, javne institucije se rukovode sledećim principima:</p> <p>1.1.Otvoreni podaci se objavljuju na sopstvenu inicijativu samih javnih institucija, bez zahteva interesnih strana, blagovremeno i na sveobuhvatan i tačan način, i sa visokim kvalitetom.</p> <p>1.2.Otvoreni podaci se objavljuju na</p> |
|---|--|---|

|   |  |  |
|---|--|--|
| <p>atë mënyrë që të jenë të qasshme nga të gjitha palët e interesuara dhe në një formë që mundësojnë përdorimin e tyre të lirë dhe të pavarur.</p> <p>1.3.Të dhënat e hapura duhet të mundësojnë krahasimin dhe ndërveprimin ndërmjet tyre dhe të publikohen në format që mundësojnë leximin nga njerëzit dhe pajisjet teknologjike.</p> <p>1.4.Të dhënat e hapura publikohen me qëllim të përmirësimit të qeverisjes dhe angazhimit qytetar në qeverisje.</p> <p>2. Institucionet publike zhvillojnë linjëveprime, të cilat mundësojnë hapjen e të dhënave nga ana e tyre, si dhe inkurajojnë qytetarët, shoqërinë civile dhe sektorin privat për hapjen e të dhënave të tyre.</p> | <p>way that they are accessible to all interested parties and in a free forms that enable their free and independent use.</p> <p>1.3.Open data shall enable comparison and interaction between them and shall be published in forms that enable people and technological devices to read them.</p> <p>1.4.Open data shall be published in order to improve governance and citizen engagement in governance.</p> <p>2. Public institutions shall develop a line of actions that enable data disclosure and encourage citizens, civil society and the private sector to disclose their data.</p> | <p>način koji je pristupačan svim interesnim stranama i u obliku, koji omogućava njihovu slobodnu i nezavisnu upotrebu.</p> <p>1.3.Otvoreni podaci treba da omogućavaju upoređivanje i interakciju između njih i da se objavljuju u oblicima koji omogućavanju čitanje od strane ljudi i tehnoloških uređaja.</p> <p>1.4.Otvoreni podaci se objavljuju sa ciljem unapređenja upravljanja i angazovanja građana u upravljanju.</p> <p>2. Javne institucije razvijaju linije delatnosti, koja omogućavaju otvaranje podataka sa njihove strane, kao i podstiču građane, civilno društvo i privatni sektor da otvaraju njihovih podataka.</p> |
| <p style="text-align: center;"><b>Neni 9</b><br/><b>Publikimi i të Dhënave të Hapura</b></p> <p>1.Të dhënat e hapura publikohen në një portal qëndror për të dhëna të hapura, i cili zhvillohet dhe menaxhohet nga ministria përgjegjëse për administratë publike.</p> <p>2.Të dhënat e hapura publikohen në format të</p>  | <p style="text-align: center;"><b>Article 9</b><br/><b>Publication of Open Data</b></p> <p>1.Open data shall be published in a central open data portal which shall be developed and managed by the ministry responsible for public administration.</p> <p>2.Open data shall be published in open format</p>   | <p style="text-align: center;"><b>Član 9</b><br/><b>Objavljivanje otvorenih podataka</b></p> <p>1.Otvoreni podaci se objavljuju na centralnom portalu za otvorene podatke, koji se razvija i upravlja od strane nadležnog ministarstva za javnu upravu.</p> <p>2.Otvoreni podaci se objavljuju u otvorenom</p>   |



|  |   |  |
|--|---|--|
| <p>hapur, i cili mundëson leximin dhe modifikimin e tyre pa barriera teknologjike, të cilat mund të lexohen nga pajisjet teknologjike dhe njerëzit, dhe që ofron qasje tek të gjitha përmbledhjet e të dhënave.</p> <p>3. Të dhënat e hapura publikohen me licencë të hapur, e cila mundëson përdorimin e lirë të të dhënave, shpërndarjen e sërishme të të dhënave, përfshirë edhe, por pa u kufizuar përmes shitjes, modifikimit dhe përfshirjes së tyre në punë më të gjëra.</p> <p>4. Me qëllim që të kenë qasje në të dhënat e hapura, përdoruesit detyrohen të tregojnë burimin e të dhënave, si dhe të njohin të drejtat e pronësisë intelektuale mbi të dhënat e personave të tjerë dhe të garantojnë paprekshmërinë e të dhënave.</p> <p>5. Institucionet publike caktojnë zyrtarin përgjegjës, i cili do të shërbejë, përveç tjerash, edhe si zytar ndërlidhës për publikim të të dhënave të hapura.</p> <p>6. Ministria përkatëse e administratës publike do të caktojë një zyrtar përgjegjës nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit për të koordinuar veprimet për publikimin e të dhënave të hapura.</p> | <p>which enables its reading and modification without technological barriers, which can be read by technological devices and people, and which provides access to the entire data collection.</p> <p>3. Open data shall be published with an open license, which allows free use and redistribution of data, including but not limited to selling, modifying and incorporating them into wider usages.</p> <p>4. In order to access open data, users shall indicate the source of data as well as recognize intellectual property rights on other person's data and guarantee the integrity of the data.</p> <p>5. Public institutions shall assign the responsible official, who shall serve, inter alia, as a liaison official for the publication of open data.</p> <p>6. The relevant ministry of public administration shall assign a responsible official from the Information Society Agency to coordinate the actions for the publication of open data.</p> | <p>formatu, koji omogućava njihovo čitanje i modifikaciju bez tehnoloških barijera, koja se mogu pročitati od strane tehnoloških uređaja i ljudi, koji i obezbeđuje pristup svim sadržajima podataka.</p> <p>3. Otvoreni podaci se objavljuju otvorenom licencom, koja omogućava slobodnu upotrebu podataka, ponovnu distribuciju podataka, uključujući, ali ne ograničavajući se na njihovu prodaju, modifikaciju i obuhvatanje na šire poslove.</p> <p>4. Da bi imali pristup otvaranim podacima, korisnici su dužni da ukažu na izvor podataka, i da priznaju prava intelektualne svojine nad podacima drugim licima i osiguraju nedodirljivost podataka.</p> <p>5. Javne institucije određuju odgovornog službenika, koji će služiti, između ostalog, i kao službenik za vezu za objavljivanje otvorenih podataka.</p> <p>6. Relevantno Ministarstvo javne uprave će odrediti odgovornog službenika od strane Agencije za informaciono društvo radi koordinacije aktivnosti za objavljivanje otvorenih podataka.</p> |
|--|---|--|

|  |  |   |
|--|--|---|
| <p><b>KAPITULLI IV<br/>QASJA NË DOKUMENTE DHE<br/>INFORMACIONE PUBLIKE NË BAZË<br/>TË KËRKESËS</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 10<br/>Kërkesa për Qasje në Dokumente dhe<br/>Informacione Publike</b></p> <p>1. Secili person ka të drejtë për qasje në dokumente publike në bazë të kërkesës.</p> <p>2. Kërkesat për qasje në dokumente publike parashtrihen në çfarëdo mënyre, e cila i mundëson institucionit publik të identifikojë nëse posedon dokumentin publik të kërkuar.</p> <p>3. Kërkesa mund të bëhet nga personi, me shkrim, në formë elektronike, ose verbalisht. Për aq sa është e mundshme, kërkesa duhet të përmbajë edhe formën e preferuar nga kërkuesi për qasje në dokumente publike.</p> <p>4. Nëse kërkesa bëhet verbalisht, zyrtari përgjegjës për qasje në dokumente publike obligohet të hartojë kërkesën me shkrim për procedim të mëtejshëm. Nëse kërkesa bëhet në formë elektronike, atëherë ajo konsiderohet si kërkesë me shkrim.</p> | <p><b>CHAPTER IV<br/>ACCESS TO PUBLIC DOCUMENTS<br/>AND INFORMATION UPON THE<br/>REQUEST</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 10<br/>Request for Access to Public Documents<br/>and Information</b></p> <p>1. Everyone has the right to access public documents upon request.</p> <p>2. Requests for access to public documents shall be submitted in any manner which allows the public institution to identify whether it possesses the requested public document.</p> <p>3. The request may be made in person, in writing, electronically or orally. As far as practicable, the request shall also contain the preferred form of the applicant to access to public documents.</p> <p>4. If the request is made orally, the official responsible for access to public documents shall compile the written request for further proceeding. If the request is made electronically, it shall be considered as a written request.</p> | <p><b>POGLAVLJE IV<br/>PRISTUP JAVNIM DOKUMENTIMA I<br/>INFORMACIJAMA NA OSNOVU<br/>ZAHTEVA</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 10<br/>Zahtev za pristup javnim dokumentima i<br/>informacijama</b></p> <p>1. Svako lice ima pravo na pristup javnim dokumentima i informacijama na osnovu zahteva.</p> <p>2. Zahtevi za pristup dokumentima se podnose na bilo koji način, koji omogućava javnoj instituciji da identifikuje da li poseduje traženi dokument ili informaciju.</p> <p>3. Zahtev se može podneti od strane lica, u pisanom, elektronskom ili usmenom obliku. Kada je to moguće, zahtev treba da sadrži i željeni oblik zahteva za pristup javnim dokumentima.</p> <p>4. Ukoliko se zahtev podnosi usmeno, odgovorni službenik za pristup javnim dokumentima se obavezuje da izradi pisani zahtev za dalje postupanje. Ukoliko se zahtev podnosi elektronski, onda se on smatra kao pisani zahtev.</p> |
|--|--|---|

|  |   |  |
|--|---|--|
| <p>5. Kërkuesi i ndonjë dokumenti publik nuk është i obliguar që të japë arsye për përdorimin e dokumenteve publik për të pasur qasje në dokumente publike.</p> <p>6. Nëse kërkesa nuk është sa duhet e saktë dhe nuk mundëson identifikimin e dokumentit publik që kërkohet, institucioni publik kërkon nga kërkuesi që ta qartësojë kërkesën dhe mund t'i ndihmojë kërkuesit që t'a bëjë një gjë të tillë.</p> <p>7. Kërkuesi i ndonjë dokumenti publik ka të drejtë që të mbetet anonim në raport me palët e treta.</p> <p>8. Institucionet publike i ofrojnë personave informata dhe ndihmë se si dhe ku mund të parashtrihen kërkesat për qasje në dokumente publike.</p> <p>9. Formalitetet për kërkesa nuk tejkalojnë atë që është e domosdoshme dhe e arsyeshme për të përpunuar kërkesën.</p> | <p>5. The applicant requesting a public document is not obliged to provide reasons for the use of public documents in order to access public documents.</p> <p>6. If the request is not sufficiently accurate and does not enable the identification of the public document required, the public institution shall ask the applicant to clarify the request and may assist the applicant to do so.</p> <p>7. The applicant requesting a public document shall have the right to remain anonymous in relation to third parties.</p> <p>8. Public institutions shall provide the persons with information and assistance on how and where to submit the requests for access to public documents.</p> <p>9. Formalities for the requests shall not go beyond what is necessary and reasonable in order to process the request.</p> | <p>5. Podnosilac zahteva za bilo koji javni dokument ili informaciju nije u obavezi da navede razloge upotrebe javnih dokumenata kao bi imao pristup javnim dokumentima.</p> <p>6. Ukoliko zahtev nije dovoljno precizan i ne omogućava identifikaciju javnog dokumenta ili informacije koja se zahteva, javna institucija zahteva od podnosioca zahteva da pojasni zahtev i može pomoći podnosiocu zahteva da to učini.</p> <p>7. Podnosilac zahteva za bilo koji javni dokument ili informaciju ima pravo da ostane anonim u odnosu na treće strane.</p> <p>8. Javne institucije pružaju licima informacije i pomoć kako da podnose zahtev za pristup javnim dokumentima .</p> <p>9. Formalnosti za zahteve ne prevazilaze ono što je neophodno i razumno za procesiranje zahteva.</p> |
| <p style="text-align: center;"><b>Neni 11</b><br/><b>Trajtimi i Kërkesave për Qasje në</b><br/><b>Dokumente Publike</b></p>  | <p style="text-align: center;"><b>Article 11</b><br/><b>Processing requests for access to public</b><br/><b>documents</b></p>   | <p style="text-align: center;"><b>Član 11</b><br/><b>Tretiranje zahteva za pristup javnim</b><br/><b>dokumentima</b></p>   |
| <p>1. Kërkesat për qasje në dokumente publike apo për ripërdorim të dokumenteve publike trajtohen nga cilido institucion publik që</p>   | <p>1. Requests for access to public documents or for reuse of public documents shall be handled by any public institution that</p>  | <p>1.Zahtevi za pristup javnim dokumentima i informacijama ili za ponovnu upotrebu informacija javnog sektora se tretiraju od</p>  |

|  |  |  |
|--|--|--|
| <p>posedon dokumentin publik të kërkuar.</p> <p>2. Zyrtari përgjegjës brenda institucionit publik, me vendim, lejon ose refuzon qasjen në dokumente publike.</p> <p>3. Nëse institucioni publik nuk prodhon apo pranon, apo nuk disponon ose nuk e kontrollon dokumentin publik të kërkuar dhe ka njohuri për institucionin publik tjetër që e ka prodhuar, pranuar, disponon apo kontrollon dokumentin publik, menjëherë, por jo më vonë se pesë (5) ditë pune nga dita e pranimit të kërkesës nga kërkuesi, detyrohet që ta informojë dhe udhëzojë kërkuesin për tek institucioni publik përkatës.</p> <p>4. Në rast se institucioni publik nuk e ka prodhuar apo pranuar, nuk disponon ose nuk e kontrollon dokumentin publik të kërkuar dhe nuk ka njohuri për institucionin publik tjetër që e ka prodhuar, pranuar, disponon apo kontrollon dokumentin publik, menjëherë, por jo më vonë se shtatë (7) ditë pune nga dita e pranimit të kërkesës nga kërkuesi, detyrohet që ta informojë për këtë kërkuesin dhe ta udhëzojë atë që t'i drejtohet Komisionerit, i cili obligohet të konfirmoj nëse dhe cili institucion publik ka prodhuar, pranuar, disponon ose kontrollon dokumentin publik të kërkuar, dhe menjëherë, por jo më</p> | <p>possesses the requested document.</p> <p>2. The responsible officer within the public institution shall, by decision, allow or refuse access to public documents.</p> <p>3. If the public institution did not produce or receive, or does not maintain or control the requested public document and has knowledge of another public institution that produced, received, maintains or controls the concerned public document, it shall immediately, but not later than five (5) business days from the day of receipt of the request by the applicant, inform and direct the applicant to the respective public institution.</p> <p>4. If the public institution did not produce or receive, nor maintains or controls the requested public document and has no knowledge of any other public institution that produced, received, maintains or controls the concerned public document, shall immediately, but no later than seven (7) business days from the day of receipt of the request by the applicant, inform and direct the applicant to the Commissioner, who is obliged to confirm whether and which public institution produced, received, maintains or controls the requested public document and immediately, but not later than seven (7)</p> | <p>strane bilo koje institucije koja poseduje traženi javni dokument.</p> <p>2. Odgovorni službenik u okviru javne institucije, odlukom, dozvoljava ili odbija pristup javnim dokumentima.</p> <p>3. Ukoliko javna institucija ne poseduje, ne raspolaže ili ne kontroliše javni dokument ili informaciju koja se traži i ima saznanja o drugoj javnoj instituciji koja poseduje, raspolaže ili kontroliše javni dokument, obavezuje se da odmah, ali ne kasnije od pet (5) radnih dana od dana prijema zahteva od strane podnosioca, informiše i uputi podnosioca zahteva na relevantnu javnu instituciju</p> <p>4. U slučaju da javna institucija ne poseduje, ne raspolaže ili ne kontroliše javni dokument koji se traži i nema saznanja o drugoj javnoj instituciji koja ga je proizvela, primila, raspolaže ili kontroliše javni dokument, obavezuje se da odmah, ali ne kasnije od sedam (7) radnih dana od dana prijema zahteva od strane podnosioca, obavezuje se da informiše o tome podnosioca zahteva i uputi ga da se obrati Povereniku, koji se obavezuje da utvrdi ukoliko i koja javna institucija je proizvela, raspolaže ili kontroliše traženi javni dokument i odmah, ali ne kasnije od sedam (7) radnih dana od</p> |
|--|--|--|

|   |  |   |
|---|--|---|
| <p>vonë se shtatë (7) ditë pune nga dita e pranimit të kërkesës, të njoftojë për këtë kërkesin.</p> <p>5. Institucioni publik ndihmon kërkesin, aq sa është e mundshme dhe e arsyeshme, të identifikojë dokumentin e kërkuar.</p> <p>6. Kërkesat për qasje në dokumente publike, apo për ripërdorim të dokumenteve publike trajtohen me shpejtësi dhe sipas parimit të objektivitetit dhe paanshmërisë sipas Ligjit përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative të Përgjithshme.</p> <p>7. Institucionet publike mund të refuzojnë të trajtojnë një kërkesë për qasje në dokumente publike, e cila ka për qëllim keqpërdorimin e kësaj të drejte ose në rastet kur institucioni ka ofruar qasje në dokumentet dhe informacionet publike të njëjta të kërkuara nga kërkesi i njëjtë më herët dhe kur nuk jepet asnjë arsytim legjitim se përse dokumenti publik i njëjtë kërkohet sërish.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 12</b><br/><b>Afatet për Trajtimin e Kërkesave për Qasje në Dokumente Publike</b></p> <p>1. Institucioni publik detyrohet që brenda shtatë (7) ditëve prej kohës së regjistrimit të</p> | <p>business days from the date of receipt of the application, notify the applicant thereof.</p> <p>5. The public institution shall assist the applicant, as far as possible and reasonable, to identify the requested document.</p> <p>6. Requests for access to public documents or reuse of public documents shall be treated rapidly and according to the principle of objectivity and impartiality pursuant to the applicable law on General Administrative Procedure.</p> <p>7. Public institutions may refuse to address a request for access to public documents intended to misuse this right or in cases where the institution has provided previous access to the same public documents upon request by the same applicant and no legitimate justification is provided as to why the same public document is requested again.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 12</b><br/><b>Timelines for handling requests for access to public documents or information</b></p> <p>1. The public institution shall, within seven (7) days from the date of recording the</p> | <p>dana prijema zahteva, da informiše o tome podnosioca zahteva.</p> <p>5. Javna institucija pomaže podnosiocu zahteva, koliko je to moguće i razumno, da identifikuje traženi dokument.</p> <p>6. Zahtevi za pristup javnim dokumentima, ili za ponovnu upotrebu javnih dokumenata se tretiraju brzo i po principu objektivnosti i nepristrasnosti prema relevantnom Zakonu o opštem upravnom postupku.</p> <p>7. Javne institucije mogu da odbiju tretiranje zahteva za pristup javnim dokumentima, koji ima za cilj zloupotrebu ovog prava i u slučajevima kada je institucija ranije pružila pristup istim javnim dokumentima i informacijama istom podnosiocu zahtevaa kad nije dao nikakvo legitimno objašnjenje zašto ponovo traži isti javni dokument..</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 12</b><br/><b>Rokovi za tretiranje zahteva za pristup javnim dokumentima</b></p> <p>1. Javna institucija se obavezuje da u roku od sedam (7) dana od trenutka registracije</p> |
|---|--|---|

|  |   |   |
|--|---|---|
| <p>kërkesës, të nxjerrë vendim për lejimin e qasjes në dokumentin e kërkuar ose të nxjerrë vendim të arsyetuar për refuzimin e plotë apo të pjesërishtë dhe informon kërkuuesin për të drejtën që ai ka për të kërkuar rishqyrtimin e kërkesës si dhe kur dhe ku të paraqitet kërkesa e tillë.</p> <p>2. Kur dokumenti publik i kërkuar, i cili në bazë të një vlerësimi të arsyeshëm shihet të jetë i nevojshëm për mbrojtjen e jetës apo lirisë së një personi, institucioni publik detyrohet të ofrojë përgjigje brenda afatit prej dyzet e tetë (48) orëve.</p> <p>3. Institucioni publik mund të vazhdojë afatin e përcaktuar nga paragrafi 1 i këtij neni për marrjen e vendimit për qasje në dokumente ose informacione publike më së shumti edhe për pesëmbëdhjetë (15) ditë shtesë, në qoftë se:</p> <p>3.1. Informata ose dokumenti duhet të kërkohet brenda një numri të madh të dokumenteve apo jashtë institucionit publik; ose</p> <p>3.2. Me një kërkesë kërkohen një numër i madh i dokumente ose informacione publike, nga e njëjta palë.</p> <p>4. Institucioni publik njofton kërkuuesin me</p> | <p>request, issue a decision to grant access to the requested document or render a justified decision for the full or partial refusal and inform the applicant of the right to request reconsideration of his request as well when and where to submit such request.</p> <p>2. Where the requested public document is considered, on the basis of a reasonable assessment, necessary for the protection of the life or liberty of a person, the public institution shall be obliged to provide an answer within forty-eight (48) hours.</p> <p>3. The public institution may extend the deadline set out under paragraph 1 of this Article for decision making on access to public documents or information to a maximum of fifteen (15) additional days if:</p> <p>3.1. The information or document has to be searched within a large number of documents or outside the public institution; or</p> <p>3.2. The same applicant requests, with a single application, a large number of documents or public information.</p> <p>4. The public institution shall notify the</p> | <p>zahteva, izdaje odluku o omogućavanju pristupa traženom dokumentu ili da izda obrazloženu odluku o potpunom ili delimičnom odbijanju i informiše podnosioca zahteva o pravu koje on ima na ponovno razmatranje zahteva kao i gde i kada da se podnese takav zahtev.</p> <p>2. Kada se traženi javni dokument, koji na osnovu razumne procene smatra neophodnim za zaštitu života i slobode određenog lica, javna institucija se obavezuje da pruži odgovor u roku od četrdeset osam (48) sati.</p> <p>3. Javna institucija može da produži rok koji je određen u stavu 1. ovog člana za donošenje odluke za pristup javnim dokumentima i informacijama za najviše petnaest (15) dodatnih dana, ukoliko:</p> <p>3.1. Informacija ili dokument treba da se traži između velikog broja dokumenata ili van javne institucije ili;</p> <p>3.2. Jednim zahtevom se zahteva veći broj javnih dokumenata ili informacija, od strane iste stranke.</p> <p>4. Javna institucija obaveštava</p> |
|--|---|---|

|   |   |   |
|---|---|---|
| <p>ecurinë dhe arsyet që kanë shkaktuar shtyrjen e afatit, menjëherë, por jo më vonë se tetë (8) ditë nga pranimi i kërkesës.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 13</b><br/><b>Zyrtarët Përgjegjës për Qasje në Dokumente Publike</b></p> <p>1. Të gjitha institucionet publike detyrohen të caktojnë njësinë apo një zyrtar përgjegjës për qasje në dokumente publike.</p> <p>2. Të gjitha kërkesat për qasje në dokumente publike, të cilat i drejtohen institucionit publik, i dërgohen njësisë apo zyrtarit përgjegjës për qasje në dokumente publike.</p> <p>3. Njësia apo zyrtari përgjegjës për qasje në dokumente publike, pas marrjes dhe shqyrtimit fillestar të kërkesës për qasje në dokumente ose publike, identifikon se cila është njësia përkatëse brenda institucionit publik që ka në posedim ose kontroll dokumentin e kërkuar.</p> <p>4. Pas lejimit të qasjes sipas këtij ligji, njësia përkatëse brenda institucionit publik, këtë dokument, në pajtim me kushtet e parapara me këtë ligj dhe ligjet tjera në fuqi, ia dërgon kërkuar të dokumentit.</p> <p>5. Njësia apo zyrtari përgjegjës për qasje në</p> | <p>applicant immediately of the progress and the reasons causing the extension of the deadline, but no later than eight (8) days after receiving the request.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 13</b><br/><b>Responsible officers for Access to Public Documents</b></p> <p>1. All public institutions shall appoint a unit or responsible for access to public documents.</p> <p>2. All requests for access to public documents addressed to the public institution shall be submitted to the unit or official responsible for access to public documents.</p> <p>3. The unit or official responsible for access to public documents shall, upon receipt and initial review of the request for access to public documents, identify which unit within the public institution possesses or controls the requested document.</p> <p>4. After granting access under this Law, the relevant unit within the public institution shall send the requested document to the applicant in accordance with the conditions provided by this Law and other applicable laws.</p> <p>5. The unit or official responsible for access</p> | <p>podnosioca zahteva o toku i razlozima koji su izazvali odlaganje roka, odmah, ali ne kasnije od osam (8) dana od prijema zahteva.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 13</b><br/><b>Odgovorni službenici za pristup javnim dokumentima</b></p> <p>1. Sve javne institucije se obavezuju da odrede jedinicu ili odgovornog službenika za pristup javnim dokumentima i informacijama.</p> <p>2. Svi zahtevi za pristup javnim dokumentima , koji se upućuju javnoj instituciji, šalju se jedinici ili odgovornom službeniku za pristup javnim dokumentima.</p> <p>3. Jedinica ili odgovorni službenik za pristup javnim dokumentima, nakon prijema i prvobitnog razmatranja zahteva za pristup javnim dokumentima i informacijama, identifikuje koja je relevantna jedinica unutar javne institucije koja poseduje ili kontroliše traženi dokument.</p> <p>4. Nakon dozvoljavanja pristupa u skladu sa ovim zakonom, relevantna jedinica unutar javne institucije, ovaj dokument, u skladu sa uslovima koji su predviđeni ovim zakonom i drugim važećim zakonima, šalje tražiocu dokumenta.</p> <p>5. Jedinica ili odgovorni službenik za pristup</p> |
|---|---|---|

|   |  |  |
|---|--|--|
| <p>dokumente publike mbanë evidencë të saktë për numrin e kërkesave për qasje në dokumente si dhe të dhëna tjera me rëndësi në lidhje me numrin e kërkesave të aprovuara, aprovuara pjesërisht dhe të refuzuara, si dhe arsyetimin e dhënë dhe informatat e tjera relevante që e bëjnë të mundur identifikimin e kërkesës përkatëse.</p> <p>6. Njësia apo zyrtari përgjegjës për qasje në dokumente dhe informacione publike përgatitë raportet e rregullta vjetore, më së largu deri më datën 31 mars të vitit të vijues, për vitin paraprak dhe këto raporte ia dërgon Komisionerit, i cili përgatitë raportin gjithëpërfshirës të institucioneve publike për realizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike.</p> <p>7. Zyra e arkivit në secilin institucion publik detyrohet që të hartojë regjistrin e dokumenteve publike që përmbanë, e që janë të qasshme lirisht për publikun. Ky regjistër duhet të përditësohet çdo tre muaj.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 14</b><br/><b>Format e Qasjes në Dokumente Publike</b></p> <p>1. Kur institucioni publik lejon qasjen në dokumente publike, kërkuesi ka të drejtë të zgjedhë formën për qasje në dokumentet të tilla.</p> | <p>to public documents shall keep accurate records of the number of requests for access to documents as well as any other relevant information regarding the number of applications approved, partially approved and rejected, as well as the reasoning provided and other relevant information that allows the identification of the respective request.</p> <p>6. The unit or official responsible for access to public documents and information shall prepare regular annual reports no later than 31 March of the following year for the previous year and shall forward these reports to the Commissioner, who shall prepare a comprehensive report of public institutions on implementation of the right of access to public documents.</p> <p>7. The archives office in each public institution shall maintain the register of public documents contained therein that are freely accessible to the public. This register shall be updated every three months.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 14</b><br/><b>Forms of access to public documents</b></p> <p>1. Where access to a public document is granted, the applicant shall have the right to choose the form of accessing such document.</p> | <p>javnim dokumentima vode tačnu evidenciju o broju zahteva za pristup dokumentima kao i o drugim podacima od značaja u vezi sa brojem usvojenih, delimično usvojenih i odbijenih zahteva, kao i obrazloženje i druge relevantne informacije koje omogućavaju da se identifikuje relevantan zahtev.</p> <p>6. Jedinica ili odgovorni službenik za pristup javnim dokumentima i informacijama priprema redovne godišnje izveštaje, najkasnije do 31. marta naredne godine, za prethodnu godinu i ove izveštaje šalje Povereniku, koji priprema sveobuhvatni izveštaj javnih institucija za realizaciju prava na pristup javnim dokumentima i informacijama.</p> <p>7. Kancelarija arhive u svakoj javnoj instituciji se obavezuje da izradi spisak javnih dokumenata koje sadrži, a koji su slobodno dostupni javnosti. Ovaj registar treba da se ažurira na svaka tri meseca.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 14</b><br/><b>Obrazac za pristup javnim dokumentima</b></p> <p>1. Kada javna institucija dozvoljava pristup javnim dokumentima ili informacijama, podnosilac zahteva ima pravo da bira oblik za pristup takvim dokumentima.</p> |
|---|--|--|



|   |  |   |
|---|--|---|
| <p>2. Në ratet kur kërkesa për qasje përmbanë një formë të parapëlqyer për qasje, atëherë institucioni publik ka për detyrim të veprojë në përputhje me atë parapëlqim.</p> <p>3. Një kërkesë mund të përmbajë format e parapëlqyera për qasje në dokumente dhe institucione publike si në vijim:</p> <p>3.1. Një kopje e saktë në formë të shtypura ose tjetër të dokumenteve ose informacionit publik të kërkuar;</p> <p>3.2. Mundësinë për shikim të dokumenteve ose informacionit publik, kurdo që është e mundshme përmes përdorimit të pajisjeve të vet institucionit;</p> <p>3.3. Mundësinë për të kopjuar dokumentet ose informacionin publik, përmes pajisjeve të vet kërkuarit;</p> <p>3.4. Një transkript të shkruar të fjalëve të përmbajtura në formë audio ose vizuale nëse ekziston apo rrjedh nga një takim i hapur;</p> <p>3.5. Një transkript të përmbajtjes së një inçizimi, në formë të shtypur, audio ose vizuale, në rastet kur një transkript i tillë ekziston, duke përdorur pajisjet, të cilat</p> | <p>2. Where a request for access contains a preferred access form, then the public institution is obliged to act in accordance with that preference.</p> <p>3. A request may indicate the preferred forms of access to public documents and information, as follows:</p> <p>3.1. An exact copy in print or other form of the requested documents;</p> <p>3.2. The opportunity to view documents or public information, whenever possible, by using the institution's own equipment;</p> <p>3.3. The possibility of copying public documents using the applicant's own equipment;</p> <p>3.4. A written transcript of words contained in audio or visual form if it exists or is derived from an open meeting;</p> <p>3.5. A transcript of the content of a printed, audio or visual recording, in the case where such a transcript exists, using equipment that is generally accessible to</p> | <p>2. U slučajevima kada zahtev za pristup sadrži poželjan obrazac za pristup, onda javna institucija ima za obavezu da deluje u skladu sa tim.</p> <p>3. Jedan zahtev može da sadrži poželjne obrasce za pristup javnim dokumentima i institucijama, kao u nastavku:</p> <p>3.1. Tačna kopija u štampanom ili drugom obliku dokumenata ili tražene javne informacije;</p> <p>3.2. Mogućnost za razmatranje dokumenata ili javne informacije, gde god da je moguće putem upotrebe opreme same institucije;</p> <p>3.3. Mogućnost za kopiranje javnih dokumenata ili informacija, putem opreme samog podnosioca zahteva;</p> <p>3.4. Pisani prepis reči sadržanih u audio ili vizuelnom obliku ukoliko postoji ili proističe iz jednog otvorenog sastanka;</p> <p>3.5. Prepis sadržaja jednog snimka, u štampanom, audio ili vizuelnom obliku, u slučajevima kada sličan prepis postoji, koristeći opremu, koja je generalno</p> |
|---|--|---|

|  |   |   |
|--|---|---|
| <p>janë përgjithësisht të qasshme për institucionin publik.</p> <p>4. Në rast se një dokument apo informacion publik ekziston në më shumë se një gjuhë, atëherë qasja ofrohet në dokumentin apo informacionin publik në gjuhën e parapëlqyer të kërkuarit.</p> <p>5. Një institucion publik nuk është i detyruar të ofrojë qasje në dokumentet publike domosdoshmërisht në formën e kërkuar nga kërkuari, në rastet kur një gjë e tillë:</p> <p>5.1. Do të ndërhynte në mënyrë të paarsyeshme në operimin efektiv të institucionit publik;</p> <p>5.2. Do të shkaktonte dëm të riparueshëm në ruajtjen, mirëmbajtjen dhe trashëgiminë e ndonjë dokumenti publik.</p> <p>5.3. Do të përbente obligim për institucionin publik që të krijojë apo të përshtatë dokumente publike apo të jep përmbledhje të informatave kur kjo do të përfshinte përpjekje joproporcionale, që shkon përtej një operimi të thjeshtë.</p> <p>6. Institucioni publik mund të ofrojë qasje në ndonjë dokument publik duke drejtuar kërkuarin në burime alternative që mund të</p> | <p>the public institution.</p> <p>4. Where a public document or information is available in more than one language, access to the public document or information shall be granted in the preferred language of the applicant.</p> <p>5. A public institution shall not necessarily be obliged to provide access to public documents in the form requested by the applicant in cases when this would:</p> <p>5.1. Interfere unreasonably with the effective operation of the public institution;</p> <p>5.2. Cause irreparable damage to the preservation, maintenance and inheritance of any public document;</p> <p>5.3. Constitute an obligation for the public institution to create or adapt public documents or provide summaries of information where this would involve disproportionate effort, going beyond a simple operation.</p> <p>6. The public institution may provide access to any public document by directing the applicant to alternative sources that are more</p> | <p>pristupačna javnoj instituciji.</p> <p>4. U slučaju da jedan dokument ili javna institucija postoji na više od jednog jezika, onda se pruža pristup javnom dokumentu ili informaciji na željenom jeziku podnosioca zahteva.</p> <p>5. Javna institucija nije obavezna da nužno pruža pristup javnim dokumentima u traženom obrascu od strane podnosioca zahteva, u slučaju kada bi takva stvar:</p> <p>5.1. Nerazumno uticala na efikasno funkcionisanje javne institucije;</p> <p>5.2. Izazvala nepopravljivu štetu u očuvanju, održavanju i nasleđivanju određenog javnog dokumenta.</p> <p>5.3. Predstavljalo bi obavezu za javne institucije da uspostave ili prilagode javna dokumanta ili da daju kratak pregled informacija gdje bi to uključilo nesrazmeran napor, koji ide izvan jednostavnog postupka.</p> <p>6. Javna informacija može da pruža pristup nekom javnom dokumentu upućivanjem podnosioca zahteva ka alternativnim izvorima</p> |
|--|---|---|

|  |  |  |
|--|--|--|
| <p>qasen më lehtë.</p> <p>7. Nëse dokumenti është bërë publik me iniciativë të institucionit publik dhe është e mundshme që kërkuesi të ketë qasje të lehtë në të, institucioni publik mund ta përmbushë detyrimin e vet të lejimit të qasjes në dokumente publike duke e informuar kërkuesin se ku dhe si ta marrë dokumentin publik të kërkuar.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 15</b><br/><b>Shpenzimet për Qasje në Dokumente Publike</b></p> <p>1. Shikimi i dokumenteve publike në objektet e institucionit publik është pa pagesë, duke mos ndaluar caktimin e tarifave për shërbimet e ndërlidhura të ofruara nga bibliotekat, arkivat dhe muzetë.</p> <p>2. Një tarifë mund t'i ngarkohet kërkuesit për kopje të dokumentit publik, e cila është e arsyeshme dhe nuk mund të tejkalojë shpenzimet e vërteta të riprodhimit dhe furnizimit të dokumentit.</p> <p>3. Kur bibliotekat, arkivat dhe muzetë kërkojnë tarifa, të ardhurat e përgjithshme nga dhënia dhe lejimi i ripërdorimit të dokumenteve publike përgjatë periudhës së</p> | <p>easily accessible.</p> <p>7. If the document has been made public upon the public institution's initiative and it is likely that the applicant has easy access to it, the public institution may fulfill its obligation to grant access to public documents by informing the applicant where and how to obtain the requested public document.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 15</b><br/><b>Costs for access to public documents</b></p> <p>1. Consultation of public documents in the public institutions' premises shall be granted free of charge, but does not exclude fees that can be imposed for related services rendered by libraries, archives and museums.</p> <p>2. Costs for a copy of a public document may be charged to the applicant, which shall be reasonable and shall not exceed the real cost for production and the service of a copy.</p> <p>3. Where charges are made by libraires, archives and museums, the total income from supplying and allowing reuse of public documents over the appropriate accounting</p> | <p>kojima se može lakše pristupiti.</p> <p>7. Ukoliko je dokument postao javan na inicijativu javne institucije i moguće je da podnosilac zahteva ima lakši pristup, javna institucija može da ispuni svoju obavezu dozvoljavanja pristupa dokumentima, informisanjem podnosioca zahteva gde i kako da preuzme traženi javni dokument</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 15</b><br/><b>Troškovi za pristup javnim dokumentima</b></p> <p>1. Uvid u službenim dokumentima u objektima javne institucije je besplatan, bez zabrane određivanja tarifa za vezane usluge koje pružaju biblioteke, arhive i muzeji.</p> <p>2. Podnosiocu zahteva se za kopiju dokumenta može naplaćivati razumna tarifa, i ne mogu se premašiti stvarni troškovi reprodukcije i isporuke dokumenta.</p> <p>3. Kada biblioteke, arhivi i muzeji zahtevaju naknade, ukupan prihod od pružanja i odobravanja ponovne upotrebe javnih dokumenata, tokom potrebnog</p> |
|--|--|--|

|   |   |   |
|---|---|---|
| <p>duhur të kontabilitetit nuk e tejkalon koston e grumbullimit, prodhimit, riprodhimit, shpërndarjes, ruajtjes dhe verifikim të të drejtave, së bashku me një kthim të arsyeshëm nga investimi.</p> <p>4. Tarifa nuk mund të ngarkohet në lidhje me kërkesat për informata personale.</p> <p>5. Tarifat për shpenzimet e prodhimit dhe dërgimit të dokumenteve apo kopjes së dokumenteve rregullohen me akt nënligjor të nxjerrë nga ministria përkatëse për financa dhe janë unike për të gjitha institucionet publike.</p> <p>6. Për tarifat standarde për ripërdorimin e dokumenteve publike, çdo kusht i vlefshëm dhe shuma e atyre tarifave, si dhe baza e llogaritjes së atyre tarifave, caktohet paraprakisht dhe publikohet, përmes mjeteve elektronike, aty ku është e mundur dhe e nevojshme.</p> <p>7. Nëse dokumentet ripërdoren nga ndonjë institucion publik si kontribut për aktivitetet e tij komerciale që janë jashtë fushëveprimit të detyrave të tij publike, tarifat e njëjta dhe kushtet e tjera që vlejné edhe për përdoruesit e tjerë vlejné edhe për dhënien e dokumenteve publike për ato aktivitete</p> | <p>period shall not exceed the cost or collection, production, reproduction, dissemination, preservation and rights clearance, together with a reasonable return on investment.</p> <p>4. No fees shall be charged concerning requests for personal information.</p> <p>5. Fees related to production and service of documents or a copy thereof shall be regulated by the sub-legal act issued by the respective Ministry of Finance and shall be unified for all public institutions.</p> <p>6. In the case of standard charges for the re-use of public documents any applicable condition and the actual amount of those charges, including the calculation basis for such charges, shall be pre-established and published, through electronic means where possible and appropriate.</p> <p>7. If documents re-used by a public institution as input for its commercial activities which fall outside the scope of its public task, the same charges and other conditions shall apply to the supply of the public documents for those activities as apply to other users.</p> | <p>računovodstvenog perioda , ne prekoračije troškove sakupljanja, proizvodnje, reprodukcije, distribucije, skladištenja i verifikacije prava, zajedno sa razumnim povraćajem investicije.</p> <p>4.Tarifa se ne može naplaćivati u vezi zahtevima za lične informacije.</p> <p>5.Tarife za troškove proizvodnje i isporučivanja dokumenata, kopije dokumenata se regulišu podzakonskim aktom izdatom od strane nadležnog ministarstva za finansije i jedinstvene su za sve javne institucije.</p> <p>6.Za standardne naknade za ponovnu upotrebu javnih dokumenata, bilo koji važeći uslov i iznosa tih tarifa kao i na osnovu obračuna tih naknada, unapred se utvrđuje i objavljuje, elektronskim putem gde je to moguće i potrebno.</p> <p>7.Ako se dokumenti ponovo koriste od strane bilo koje javne institucije kao doprinos njenim komercijalnim aktivnostima koje su izvan okvira njegovih javnih dužnosti, iste tarife i drugi uslovi koji se odnose na druge korisnike važe i za dodelu javnih dokumenata za te aktivnosti</p> |
|---|---|---|

|   |   |  |
|---|---|--|
| <p style="text-align: center;"><b>Neni 16</b><br/><b>Ndalimi i Aranzhimeve Ekskluzive</b></p> <p>1. Ripërdorimi i dokumenteve është i hapur për të gjitha palët potenciale në treg, edhe nëse një apo më shumë palë e tregut veçse i shfrytëzojnë produktet me vlerë të shtuar në bazë të këtyre dokumenteve. Kontratat apo aranzhimet e tjera mes organeve të sektorit publik që i mbajnë dokumentet dhe palët e treta nuk lejohet të garantojnë të drejta ekskluzive.</p> <p>2. Megjithatë, kur e drejta ekskluzive është e domosdoshme për ofrimin e ndonjë shërbimi në interesin publik, vlefshmëria e arsyes për dhënie të drejte të tillë ekskluzive i nënshtrohet shqyrtimit të rregullt, dhe, në çdo rast, shqyrtohet çdo tri vite.</p> | <p style="text-align: center;"><b>Article 16</b><br/><b>Prohibition of exclusive arrangements</b></p> <p>1. The re-use of documents shall be open to all potential actors in the market, even if one or more market players already exploit added-value products based on these documents. Contracts or other arrangements between the public sector bodies holding the documents and third parties shall not grant exclusive rights.</p> <p>2. However, where an exclusive right is necessary for the provision of a service in the public interest, the validity of the reason for granting such an exclusive right shall be subject to regular review, and shall, in any event, be reviewed every three years. The exclusive arrangements established after the entry into force of this Directive shall be transparent and made public.</p> | <p style="text-align: center;"><b>Član 16</b><br/><b>Zabrana ekskluzivnih aranžmana</b></p> <p>1. Ponovna upotreba dokumenata je otvorena za sve potencijalne stranke na tržištu, čak i ako jedna ili više tržišnih stranaka već koriste proizvode sa dodatnom vrednošću na osnovu ovih dokumenata. Ugovore ili druge dogovore između organa javnog sektora koji drže dokumente i trećim licima se ne dozvoljava da garantuju ekskluzivna prava.</p> <p>2. Međutim, kada je izričito pravo beophodno za pružanje usluga u javnom interesu validnost razloga za davanje takvog ekskluzivnog prava podleže redovnom pregledu, i, u svakom slučaju, razmatra se svake tri godine.</p> |
| <p style="text-align: center;"><b>KAPITULLI V</b><br/><b>REFUZIMI I QASJES NË DOKUMENTE DHE INFORMACIONE PUBLIKE</b></p>  | <p style="text-align: center;"><b>CHAPTER V</b><br/><b>REFUSAL OF ACCESS TO PUBLIC DOCUMENTS AND INFORMATION</b></p>  | <p style="text-align: center;"><b>POGLJAVLJE V</b><br/><b>ODBIJANJE PRISTUPA JAVNIM DOKUMENTIMA I INFORMACIJAMA</b></p>  |
| <p style="text-align: center;"><b>Neni 17</b><br/><b>Bazat e Lejueshme për Refuzimin e Qasjes në Dokumente Publike</b></p> <p>1. Çdo kërkues ka të drejtë të ketë qasje në</p>  | <p style="text-align: center;"><b>Article 17</b><br/><b>Allowed basis for refusing access to public documents</b></p> <p>1. Any applicant shall have the right to access</p>  | <p style="text-align: center;"><b>Član 17</b><br/><b>Dozvoljeni osnov za odbijanje pristupa javnim dokumentima</b></p> <p>1. Svaki podnosilac zahteva ima pravo da ima</p>   |

|   |   |   |
|---|---|---|
| <p>dokumente publike. Pavarësisht nga cilido paragraf i këtij neni, një institucion publik nuk mund të refuzojë të tregojë nëse ka në posedim një dokument apo të refuzojë qasjen në një dokument publik, përderisa nuk bën një test të dëmit dhe interesit publik për të përcaktuar nëse dëmi i shkaktuar interesit të mbrojtur mbisundon interesin e publikut për qasje në atë dokument publik.</p> <p>2. Kufizimi i të drejtës për qasje në dokumente publike ushtrohet në përputhje me parimin e proporcionalitetit sipas ligjit përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në përputhje me këtë ligj dhe vetëm për qëllime të mbrojtjes së:</p> <p>2.1. sigurisë shtetërore, mbrojtjes dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare;</p> <p>2.2. jetës, shëndetit dhe të sigurisë publike;</p> <p>2.3. parandalimit, hetimit dhe ndjekjes së veprave penale në rastet kur publikimi i dokumenteve publike mund të dëmtojë procesin e hetimit;</p> <p>2.4. hetimet disiplinore, në rastet kur publikimi i dokumenteve apo informatave publike mund të dëmtojë procedurën disiplinore;</p> | <p>public documents. Notwithstanding any paragraph of this Article, a public institution may not refuse to inform on whether it has a document or information in its possession or refuse access to a public document, unless it performs a damage and public interest test to determine whether the damage caused to the protected interest overrides the public interest in accessing that public document.</p> <p>2. Limitation of the right of access to public documents shall be exercised in accordance with the principle of proportionality pursuant to the applicable law on General Administrative Procedure in accordance with this Law and only for the purpose of protection of:</p> <p>2.1. national security, defense and international relations;</p> <p>2.2. public life, health and public security;</p> <p>2.3. prevention, investigation and persecution of criminal activities in cases where the publication of public documents may damage the investigation process;</p> <p>2.4. disciplinary investigations in cases when the publication of public documents or information may damage the disciplinary procedure;</p> | <p>pristup javnim dokumentima i informacijama. Bez obzira na bilo koji stav ovog člana, javna institucija ne može odbiti da pokaže da li ima u posedu dokument ili da odbije pristup javnom dokumentu, dok ne izvrši ispitivanje štete i javnog interesa kako bi utvrdilo ukoliko bi prouzrokovana šteta zaštićenom interesu prevladavala interes javnosti za pristup tom javnom dokumentu.</p> <p>2. Ograničavanje prava na pristup javnim dokumentima se vrši proporcionalno i u skladu sa ovim zakonom o opštem upravnom postupku, u skladu sa ovim zakonom i samo u cilju zaštite:</p> <p>2.1.državne bezbednosti, odbrane i međunarodnih odnosa;</p> <p>2.2. života, zdravlja i javne bezbednosti;</p> <p>2.3. sprečavanja, istraživanja i gonjenja krivičnih dela u slučajevima kada objavljivanje javnih dokumenata može oštetiti proces istrage;</p> <p>2.4. disciplinske istrage, u slučajevima kada objavljivanje dokumenata ili informacija može oštetiti disciplinski postupak;</p> |
|---|---|---|

|   |   |  |
|---|---|--|
| <p>2.5. inspektimit, kontrollimit dhe mbikëqyrjes nga institucionet publike në rastet kur trajtojnë informacion të klasifikuar;</p> <p>2.6. të drejtës për privatësi;</p> <p>2.7. konfidencialitetit komercial siç janë sekretet e biznesit, sekretet profesionale apo të kompanisë;</p> <p>2.8. dokumenteve për të cilat institucioni publik apo palët e treta gëzojnë të drejtat e pronësisë intelektuale;</p> <p>2.9. politikave ekonomike, monetare dhe këmbimore të shtetit;</p> <p>2.10 konfidencialitet statistikor;</p> <p>2.11. barazisë së palëve në procedura gjyqësore dhe administrimin efikas të drejtësisë;</p> <p>2.12. diskutimeve brenda apo ndërmjet institucioneve publike lidhur me shqyrtimin e ndonjë çështjeje, e cila përbën informacion të klasifikuar.</p> <p>3. Qasja në dokumente publike gjithnjë</p> | <p>2.5. inspection, control and supervision by public institutions in cases of handling classified information;</p> <p>2.6. right to privacy;</p> <p>2.7. commercial confidentiality such as business, professional or company secrets;</p> <p>2.8. documents for which the public institution or third parties hold intellectual property rights;</p> <p>2.9. state economic, monetary and exchange policies;</p> <p>2.10. statistical confidentiality;</p> <p>2.11. equality of parties in court procedure and efficient administration of justice;</p> <p>2.12. the deliberations within or between the public institutions concerning the examination of an issue, which contains classified information.</p> <p>3. Access to public documents shall always</p> | <p>2.5. inspekcije, kontrole i nadzora od strane javnih institucija kada se bave poverljivim informacijama;</p> <p>2.6. prava na privatnosti;</p> <p>2.7. komercijalne poverljivosti kao što su poslovne tajne, stručne tajne ili tajne kompanije;</p> <p>2.8. dokumenta na koja jave institucije ili treće strane uživaju prava intelektualne svojine;</p> <p>2.9. ekonomskih politika , monetarnih i politika razmene, države;</p> <p>2.10 statistička poverljivost</p> <p>2.11. jednakosti stranaka u sudskim postupcima i efikasno upravljanje pravde;</p> <p>2.12. diskusija unutar ili između javnih institucija u vezi sa razmatranjem nekog pitanja, koje predstavlja poverljivu informaciju.</p> <p>3. Pristup javnim dokumentima uvek se</p> |
|---|---|--|

|  |  |  |
|--|--|--|
| <p>lejohet, nëse:</p> <p>3.1. Dokumenti publik i kërkuar ka të bëjnë me shpenzimet e parasë publike;</p> <p>3.2. Dokumenti publik lidhet me zbatimin e funksioneve publike ose marrëdhëniet e punësimit të nëpunësve civilë, përveç në rastet kur ka të dhëna personale të mbrojtura apo kur saktësohet ndryshe në ligjet përkatëse.</p> <p>3.3. Dokumenti publik i kërkuar ka të bëjnë me mjedisin, mbeturinat, substanca të rrezikshme ose informata të raporteve të sigurisë në mjedis, ashtu si janë të parapara me ligjin përkatës për mbrojtjen e mjedisit.</p> <p>4. Nëse vetëm një pjesë e dokumenteve publike të kërkuara mbulohet me ndonjë prej përjashtimeve të përmendura në paragrafin 2 të këtij neni, pjesët e mbetura të dokumentit publik bëhen publike.</p> <p>5. Kërkesa për qasje në dokumente publike mund të refuzohet nëse:</p> <p>5.1. pa marrë parasysh ndihmën nga institucioni publik, kërkesa mbetet tejet e paqartë për të mundësuar identifikimin e</p> | <p>be granted if:</p> <p>3.1. The public document requested is related to public money expenditures;</p> <p>3.2. The public document relates to the discharge of public functions or employment relationships of civil servants, except in cases where personal protected data is involved or when specified differently in the relevant laws.</p> <p>3.3. The requested public document relates to the environment, waste, hazardous substances or information of environmental safety reports as provided for by the relevant environmental protection law.</p> <p>4. If only a part of a requested public document is covered by any of the exceptions listed in paragraph 2 of this Article, the remaining parts of the public document shall be released.</p> <p>5. The request for access to public documents may be refused:</p> <p>5.1. if, regardless the assistance by the public institution, the application remains quite unclear to enable the</p> | <p>dozvoljava, ukoliko:</p> <p>3.1. Zahtevani javni dokument se odnosi se na trošenje javnog novca;</p> <p>3.2. JAVni dokument se odnosi na sprovođenje javnih funkcija ili radnih odnosa civilnih službenika, osim u slučajevima kada sadrži zaštićene lične podatke ili kada se drugačije navodi u relevantnim zakonima.</p> <p>3.3. Zahtevani javni dokument se odnosi na životnu sredinu, otpad, opasne materije ili informacije o izveštajima o bezbednosti životne sredine, kao što je predviđeno relevantnim zakonom o zaštiti životne sredine.</p> <p>4. Ukoliko je samo jedan deo zahtevanih dokumenata obuhvaćen sa nekim od pomenutih izuzetaka navedenih u stavu 2. ovog člana, preostali delovi javnog dokumenta se objavljuju.</p> <p>5. Zahtev za pristup javnim dokumentima se može odbiti ukoliko:</p> <p>5.1. bez obzira na pomoć javne institucije, zahtev ostaje izuzetno nejasan da bi se omogućilo</p> |
|--|--|--|



|  |  |  |
|--|--|--|
| <p>dokumentit;</p> <p>5.2. nëse janë plotësuar kushtet dhe kërkesat nga paragrafët 2 dhe 4 i këtij neni.</p> <p>6. Para marrjes së vendimit për refuzimin e kërkesës për qasje në dokumente publike në tërësi ose pjesërisht, sipas paragrafit 2 të këtij neni, institucioni publik detyrohet të bëjë testin e dëmit dhe të interesit publik në përputhje me nenin 18 të këtij ligji.</p> <p>7. Institucioni publik, i cili refuzon qasjen në dokumentin publik në tërësi apo pjesërisht, duhet të nxjerrë vendim për refuzim dhe në të të japë arsye mbi refuzimin dhe të shpjegojë arsyet se si ka bërë testin sipas nenit 18 të këtij ligji dhe si ka ardhur në përfundimin për të refuzuar qasjen sipas paragrafit 2 të këtij neni.</p> <p>8. Vendimi duhet të jetë me shkrim dhe duhet t'i dorëzohet kërkuarit personalisht, përmes postës së regjistruar apo përmes e-mailit, në rast se kërkuari ka përdorur këtë metodë për të kërkuar dokumentin publik dhe duhet të përmbajë mjetin juridik që kërkuari mund të përdorë kundër vendimit për refuzim.</p> | <p>identification of a document;</p> <p>5.2. if the conditions and requirements from paragraphs 2 and 4 of this Article are met.</p> <p>6. Prior to making a decision to completely or partially refuse access to public documents, in accordance with paragraph 2 of this Article, the public institution shall conduct a damage and public interest test in accordance with Article 18 of this Law.</p> <p>7. The public authority completely or partially refusing access to a public document shall issue a decision on refusal stating the reasons for refusal and explaining how it conducted the test pursuant to Article 18 of this Article and how it reached the conclusion to refuse access according to paragraph 2 of this Article.</p> <p>8. The decision shall be in writing and be submitted to the applicant personally, via registered mail or e-mail, if the applicant has used this method to request the public document and must contain the remedy that the applicant may use against the decision for refusal.</p> | <p>identifikovanje dokumenata; ili</p> <p>5.2. ukoliko su ispunjeni uslovi i zahtevi iz stava 2 i 4. ovog člana.</p> <p>6. Pre donošenja odluke o odbijanju zahteva za pristup javnim dokumentima i u potpunosti ili delimično, u smislu stava 2. ovog člana, javna institucija je obavezna da izvrši ispitivanje štete i javnog interesa u skladu sa članom 18. ovog zakona.</p> <p>7. Javna institucija koja u potpunosti ili delimično odbija pristup javnom dokumentu, treba da donese odluku o odbijanju i navede razloge odbijanja i da objasni razloge kako je izvršeno ispitivanje prema članu 18. ovog zakona i kako je došla do zaključka da se odbije pristup u skladu sa stavom 2. ovog člana.</p> <p>8. Odluka treba da bude u pisanom obliku i treba da se dostavi podnosiocu zahteva lično, putem preporučene pošte ili putem e-maila, u slučaju da je podnosilac zahteva koristio ovaj metod da zahteva jahni dokument i treba da sadrži pravni lek koji podnosilac zahteva može da upotrebi protiv odluke za odbijanje.</p> |
|--|--|--|

| <p align="center"><b>Neni 18</b><br/><b>Testi i Dëmit dhe Interesit Publik</b></p>  | <p align="center"><b>Article 18</b><br/><b>Damage and Public Interest Test</b></p>   | <p align="center"><b>Član 18</b><br/><b>Ispitivanje štete i javnog interesa</b></p>   |
|---|--|---|
| <p>1. Para se të vendosë për refuzimin e kërkesës për qasje në dokumente publik, sipas nenit 17 të këtij ligji, institucionet publike detyrohen të bëjnë testin e dëmit dhe të interesit publik.</p> <p>2. Institucionet publike përcaktojnë, në bazë të testit të dëmit dhe të interesit publik, në rast se interesat e mbrojtura me paragrafin 2 të nenit 17 mbisundojnë interesin publik për publikimin e dokumenteve publike.</p> <p>3. Komisioneri, jo më larg se një (1) vit nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miraton udhëzime të qarta për insitucionet publike për përmbajtjen dhe mënyrën e bërjes së testit të dëmit dhe të interesit publik në procedurën e marrjes së vendimit dhe arsyetimit të vendimeve për refuzimin e qajes në dokumente dhe informacione publike në bazë të nenit 17 të këtij ligji.</p> <p>4. Nëse kërkesa ka të bëjë me cilëndo nga çështjet e cekura në nenin 17 paragrafin 3 të këtij Ligji, dokumentet publike duhet të bëhen të qasshme pa bërë ndonjë lloj testi, përveç nëse janë të kufizuara me ndonjë ligj tjetër në fuqi.</p> | <p>1. Prior to making a decision to refuse a request for access to public documents in accordance with Article 17 of this Law, the public institution shall conduct a damage and public interest test.</p> <p>2. Public institutions shall determine, on the basis of the damage and public interest test, if the interests protected by paragraph 2 of Article 17 override the public interest for publication of public documents.</p> <p>3. The Commissioner shall, no later than one (1) year from the entry into force of this Law, adopt clear instructions for public institutions on the content and manner of conducting the damage and public interest test within the procedure of decision making and justifying decisions to refuse access to public documents and information pursuant to Article 17 of this Law.</p> <p>4. If the request relates to any of the issues enumerated in Article 17 paragraph 3 of this Law, the public documents shall be made accessible without any test, unless otherwise provided by any other applicable law.</p> | <p>1. Pre donošenja odluke o odbijanju zahteva za pristup javnim dokumentima ili informacijama, u skladu sa članom 17. ovog zakona, javne institucije su obavezne da izvrše ispitivanje štete i javnog interesa.</p> <p>2. Javne institucije određuju, na osnovu ispitivanja štete i javnog interesa, ukoliko interesi zaštićeni stavom 2. člana 17. prevladavaju nad javnim interesom za objavljivanje javnih dokumenata i informacija.</p> <p>3. Poverenik će, ne kasnije od jedne (1) godine od stupanja na snagu ovog zakona, usvojiti jasna uputstva za javne institucije o sadržaju i načinu ispitivanja štete i javnog interesa u postupku donošenja odluke i obrazloženja odluka o odbijanju pristupa javnim dokumentima i informacijama u skladu sa članom 17. ovog zakona.</p> <p>4. Ukoliko se zahtev odnosi na bilo koje pitanje navedeno u članu 17 stav tri ovog zakona, javna dokumenta će biti dostupna bez izvođenja bilo kakvog ispitivanja, osim ukoliko su ograničeni nekim drugim važećim zakonom.</p> |

|   |   |  |
|---|---|--|
| <p style="text-align: center;"><b>Neni 19</b><br/><b>Heshtja ose Mospërgjigja e Institucionit Publik</b></p> <p>Heshtja ose mospërgjigja e institucionit publik brenda afatit të caktuar me këtë ligj, konsiderohet si përgjigje negative dhe i jep të drejtë kërkuarit që të ndjekë procedurat mbi ankimin administrativ dhe procedurën gjyqësore në përputhje me Kapitullin VII të këtij ligji.</p> <p><b>KAPITULLI VI</b><br/><b>ANKESAT DHE MJETET JURIDIKE</b><br/><b>NDARJ REFUZIMIT TË QASJES NË</b><br/><b>DOKUMENTE PUBLIKE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 20</b><br/><b>Ankesa Pranë Komisionerit</b></p> <p>1. Në rast se institucioni publik ka refuzuar në tërësi apo pjesërisht kërkesën për qasje në dokumente publike, kërkuari mund t'i drejtohet me ankesë Komisionerit brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve prej pranimit të vendimit për refuzim ose vendimit për aprovim të pjesshëm të kërkesës për qasje.</p> <p>2. Komisioneri, ankesën e pranuar ia komunikon institucionit publik që ka vendosur në lidhje me kërkesën për qasje, i</p> | <p style="text-align: center;"><b>Article 19</b><br/><b>Silence or failure of the public institution to reply</b></p> <p>Silence or failure by the public authority to reply within the time limit prescribed by this Law shall be considered as a negative reply and entitle the applicant to initiate administrative appeal and court proceedings in accordance with Chapter VII of this Law.</p> <p><b>CHAPTER VI</b><br/><b>COMPLAINTS AND REMEDIES</b><br/><b>AGAINST REFUSAL OF ACCESS TO</b><br/><b>PUBLIC DOCUMENT</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 20</b><br/><b>Complaint with the Commissioner</b></p> <p>1. If the public institution has completely or partially refused the request for access to public documents, the applicant may address a complaint to the Commissioner within a time limit of fifteen (15) days from the receipt of the decision on refusal or decision for partial approval of the request for access.</p> <p>2. The Commissioner shall communicate the complaint received to the public institution that has decided on the request for access,</p> | <p style="text-align: center;"><b>Član 19</b><br/><b>Čutanje i neodgovaranje javne institucije</b></p> <p>Čutanje ili neodgovaranje javne institucije u roku koji je određen ovim zakonom smatra se negativnim odgovorom i daje pravo podnosiocu zahteva da vodi postupke u upravnoj žalbi i sudski postupak u skladu sa poglavljem VII ovog zakona.</p> <p><b>POGLAVLJE VI</b><br/><b>ŽALBE I PRAVNI LEKOVI PROTIV</b><br/><b>ODBIJANJA PRISTUPA JAVNIM</b><br/><b>DOKUMENTIMA</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 20</b><br/><b>Žalba pred Poverenikom</b></p> <p>1. U slučaju da je javna institucija u potpunosti ili delimično odbila zahtev za pristup javnim dokumentima, podnosilac zahteva može uputiti žalbu Povereniku u roku od petnaest (15) dana od dana prijema odluke o odbijanju ili odluke o delimičnom odobravanju zahteva za ponovno razmatranje.</p> <p>2. Poverenik primljenu žalbu saopštava javnoj instituciji koja je odlučila u vezi zahtevom za pristup, , koji treba da u roku od</p> |
|---|---|--|

|   |   |  |
|---|---|--|
| <p>cili duhet që brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të ankesës të ofrojë përgjigje me shkrim ndaj pretendimeve të ngritura nga ankuesi.</p> <p>3. Pas pranimit të përgjigjes nga ana e institucionit publik ose në rast të mospërgjigjes, Komisioneri vendosë në lidhje me ankesën në afatin prej tridhjetë (30) ditëve. Komisioneri, me akt të brendshëm, vendosë për procedurën dhe mënyrën e vendosjes brenda këtij institucioni.</p> <p>4. Komisioneri mund të aprovojë në tërësi ankesën dhe ta ndryshojë vendimin e institucionit publik, në atë mënyrë që i lejon qasjen kërkuarit tërësisht në dokumentet publike të kërkuara, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.</p> <p>5. Komisioneri mund të aprovojë pjesërisht ankesën dhe ta ndryshojë vendimin e institucionit publik në atë mënyrë që i lejon qasjen kërkuarit pjesërisht në dokumentet publike të kërkuara, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.</p> <p>6. Institucioni publik detyrohet të veprojë sipas vendimit të Komisionerit në afat prej shtatë (7) ditëve.</p> <p>7. Komisioneri mund të refuzojë ankesën dhe</p> | <p>which shall within seven (7) days of receipt of the complaint issue a written response to the allegations raised by the complainant.</p> <p>3. Upon receipt of the response by the public institution or in case of non-response, the Commissioner shall decide on the complaint within thirty (30) days. The commissioner, by means of an internal act, shall decide on the procedure and the manner of decision within this institution.</p> <p>4. The Commissioner can fully approve the complaint and modify the decision of the public institution in such a way as to grant the applicant full access to all public documents requested, in accordance with the provisions of this Law.</p> <p>5. The Commissioner may partially approve the complaint and modify the decision of the public institution in such a way as to allow the applicant partial access to public documents requested, in accordance with the provisions of this Law.</p> <p>6. The public institution is obliged to act pursuant to the decision of the Commissioner within seven (7) days.</p> <p>7. The Commissioner may refuse the</p> | <p>sedam (7) dana od prijema žalbe pruži pismeni odgovor na navode podnete od podnosioca žalbe.</p> <p>3. Nakon prijema odgovora od strane javne institucije ili u slučaju ne odgovaranja , Poverenik odlučuje o žalbi u roku od trideset (30) dana. Poverenik internim aktom odlučuje o postupku i načinu odlučivanja u okviru ove institucije.</p> <p>4. Poverenik može u potpunosti da odobri žalbu i izmeni odluku javne institucije na način koji dozvoljava podnosiocu zahteva potpuni pristup javnim dokumentima koji su zahtevani u skladu sa odredbama ovog zakona.</p> <p>5. Poverenik može da delimično odobri žalbu i izmeni odluku javne institucije na način koji dozvoljava podnosiocu zahteva delimičan pristup javnim dokumentima u skladu sa odredbama ovog zakona</p> <p>6. Javna institucija je obavezna da postupi po odluci Poverenika u roku od sedam (7) dana.</p> <p>7. Poverenik može odbiti žalbu i ostaviti na</p> |
|---|---|--|

|  |   |  |
|--|---|--|
| <p>të lëjë në fuqi vendimin e institucionit publik për refuzimin ose aprovimin e pjesërishëm të qasjes në dokumente publike.</p> <p>8. Në rast të refuzimit të plotë apo të pjesërishëm të ankesës, Komisioneri nxjerr vendim, i cili duhet të përmbajë arsyet për refuzimin e ankesës dhe mjetin juridik që kërkuesi mund ta përdorë kundër vendimit mbi refuzimin e ankesës.</p> <p>9. Vendimi duhet të jetë me shkrim dhe duhet t'i dorëzohet kërkuesit personalisht, përmes postës së regjistruar apo përmes e-mailit, në rast se kërkuesi ka përdorur këtë metodë për të paraqitur kërkesën për rishqyrtim.</p> <p>10. Vendimi i Komisionerit është përfundimtar në procedurën administrative, sipas kërkesës së kërkuesit dhe obligativ, i cili mund të kundërshtohet vetëm përmes padisë në gjykatën kompetente për çështje administrative.</p> | <p>complaint and uphold the decision of the public institution on refusal or partial approval of access to public documents.</p> <p>8. In case of a full or partial refusal of the complaint, the Commissioner shall issue a decision that will contain the reasons for refusal of the complaint and the legal remedy that the applicant may employ against the decision on refusal of the complaint.</p> <p>9. The decision must be in writing and must be submitted to the applicant personally, via registered mail or via e-mail, if the applicant has used this method to submit the request for review.</p> <p>10. In administrative procedure the Commissioner's decision is final and obligatory with regard to the request of the applicant, and can only be challenged through an application before the competent court of administrative matters.</p> | <p>snazi odluku javne institucije za odbijanje ili delimično odobrenje pristupa javnim dokumentima</p> <p>8. U slučaju potpunog ili delimičnog odbijanja žalbe, Poverenik donosi odluku koja treba da sadrži razloge za odbijanja žalbe i pravni lek koji podnosilac zahteva može koristiti protiv odluke o odbijanju žalbe.</p> <p>9. Odluka treba da bude u pisanom obliku i treba da se dostavi podnosiocu zahteva lično, putem preporučene pošte ili putem e-maila, ukoliko je podnosilac zahteva koristio ovaj metod da podnese zahtev za ponovno razmatranje.</p> <p>10. Odluka Poverenika je konačna u upravnom postupku, prema zahtevu podnosioca i obavezujuća, koja se može osporiti samo putem tužbe u nadležnom sudu za upravne poslove.</p> |
| <p style="text-align: center;"><b>Neni 21</b><br/><b>Institucioni i Avokatit të Popullit</b></p> <p>1. Institucioni i Avokatit të Popullit është organ i pavarur, i cili ndihmon qytetarët në realizimin e të drejtës për qasje në dokumentet publike sipas Kushtetutës, këtij</p>   | <p style="text-align: center;"><b>Article 21</b><br/><b>The Ombudsperson Institution</b></p> <p>1. The Ombudsperson Institution is an independent body, which shall assist citizens in realization of their right for access to public documents pursuant to Constitution,</p>  | <p style="text-align: center;"><b>Član 21</b><br/><b>Institucija Ombudsmana</b></p> <p>1. Institucija Ombudsmana je nezavisni organ koji pomaže građanima u ostvarivanju prava pristupa javnim dokumentima u skladu sa Ustavom, ovim zakonom i relevantnim</p>   |

|   |   |  |
|---|---|--|
| <p>ligji, dhe ligjet përkatëse që rregullojnë fushëveprimin dhe përgjegjësitë e Avokatit të Popullit.</p> <p>2. Institucioni i Avokatit të Popullit kujdeset për realizimin e papengueshëm të së drejtës për qasje në dokumente publike, sidomos duke:</p> <p>2.1. ndërmarrë masa të nevojshme për të promovuar dhe përkrahur të drejtat themelore për qasje në dokumente publike;</p> <p>2.2. ndërmarrë masa të nevojshme për edukimin e publikut dhe të institucioneve publike për të drejtat dhe detyrimet e tyre për qasje në dokumente publike.</p> <p>3. Secili person ka të drejtë që gjatë të gjitha fazave të procedurës t'i drejtohet Institucionit të Avokatit të Popullit me kërkesë apo ankesë nëse konsideron që ndonjë e drejtë e njohur me këtë Ligj apo akte të tjera për qasje në dokumente publike është cënuar.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 22</b><br/><b>Kërkesa për Mbrojtje Gjyqësore përmes Gjykatës</b></p> <p>Në rast të refuzimit të plotë apo të pjesshëm të</p> | <p>this Law and respective laws governing the scope and responsibilities of the Ombudsperson.</p> <p>2. The Ombudsperson Institution shall ensure the unobstructed exercise of the right of access to public documents, notably by:</p> <p>2.1.undertaking the necessary measures to promote and support the fundamental rights of access to public documents;</p> <p>2.2. undertaking necessary measures for educating the public and public institutions of their rights and obligations for access to public documents.</p> <p>3. Each person has the right to address the Ombudsperson Institution during all the phases of the procedure with a request or a complaint, if they consider that any right acknowledged by this Law or other acts for access to public documents has been violated.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 22</b><br/><b>Request for Judicial Protection through the Court</b></p> <p>In the event of a full or partial rejection of the</p> | <p>zakonima koji regulišu delokrug i odgovornosti Ombudsmana.</p> <p>2. Institucija Ombudsmana se stara o neometanoj realizaciji prava pristupa javnim dokumentima, posebno kroz:</p> <p>2.1.preduzimanje neophodnih mera radi promovisanja i podrške osnovnih prava na pristup javnim dokumentima;</p> <p>2.2.preduzimanje neophodnih mera za edukaciju javnosti i javnih institucija o njihovim pravima i obavezama za pristup javnim dokumentima.</p> <p>3. Svako lice ima pravo da se tokom svih faza postupka obrati Instituciji Ombudsmana zahtevom ili žalbom ukoliko smatra da je neko pravo koje je ovim zakonom ili drugim aktima priznato za pristup javnim dokumentima ugroženo.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 22</b><br/><b>Zahtev za sudsku zaštitu putem Suda</b></p> <p>U slučaju potpunog ili delimičnog odbijanja</p> |
|---|---|--|

|   |   |  |
|---|---|--|
| <p>ankesës nga ana e Komisionerit, në përputhje me nenin 20 të këtij ligji, kërkuesi mund t'i drejtohet me padi gjykatës kompetente për çështje administrative brenda tridhjetë (30) ditëve prej ditës së pranimit të vendimit përfundimtar nga Komisioneri.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 23</b><br/><b>Aplikimi i Dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative</b></p> <p>Në procedurën e realizimit të të drejtës për qasje në dokumente publike, në mënyrë të përshtatshme, aplikohen dispozitat e ligjit për procedurën e përgjithshme administrative të Republikës së Kosovës, nëse me dispozitat e këtij ligji nuk është përcaktuar ndryshe.</p> <p><b>KAPITULLI VII</b><br/><b>RIPËRDORIMI I DOKUMENTEVE DHE TË DHËNAVE PUBLIKE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 24</b><br/><b>E Drejta për Ripërdorim të Dokumenteve Publike</b></p> <p>Secili person ka të drejtë të ripërdorë dokumentet publike, për qëllime komerciale ose jo, në përputhje me dispozitat dhe kufizimet e përcaktuara me këtë ligj.</p> | <p>complaint by the Commissioner, in accordance with Article 20 of this Law, the applicant may lodge a complaint before the competent court for administrative matters within thirty (30) days from the day of receipt of the final decision by the Commissioner.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 23</b><br/><b>Application of the General Provisions of the Law on General Administrative Procedure</b></p> <p>In proceedings for realization of the right of access to public documents, the provisions of the Law on General Administrative Procedure of the Republic of Kosovo shall apply accordingly, unless otherwise defined by the provisions of this Law.</p> <p><b>CHAPTER VII</b><br/><b>RE-USE OF PUBLIC DOCUMENTS AND DATA</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 24</b><br/><b>The Right for the Re-use of Public Documents</b></p> <p>Any person has the right to re-use public documents, either for commercial purposes or not, in compliance with the provisions and limitations set forth by this Law.</p> | <p>žalbe od strane Poverenika, u skladu sa članom 20. ovog zakona, podnosilac zahteva može uputiti tužbu nadležnom sudu za administrativna pitanja u roku od trideset (30) dana od dana prijema konačne odluke od strane Poverenika.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 23</b><br/><b>Primenjivanje odredbi Zakona o opštem upravnom postupku</b></p> <p>U postupku ostvarivanja prava na pristup javnim dokumentima, na prikladan način, primenjuju se odredbe Zakona o opštem upravnom postupku Republike Kosovo, osim ukoliko je odredbama ovog zakona drugačije određeno.</p> <p><b>POGLAVLJE VII</b><br/><b>PONOVNA UPOTREBA JAVNIH DOKUMENATA I PODATAKA</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 24</b><br/><b>Pravo na ponovnu upotrebu informacija javnog sektora</b></p> <p>Svako lice ima pravo da ponovo upotrebi podatke javnog sektora, u komercijalne svrhe ili ne, u skladu sa odredbama i ograničenjima određenim ovim zakonom.</p> |
|---|---|--|

|   |  |  |
|---|--|--|
| <p style="text-align: center;"><b>Neni 25</b><br/><b>Kërkesa dhe Lejimi i Qasjes për Ripërdorim</b></p> <p>Dispozitat e kapitujve III deri V në lidhje me kërkesat për qasje në dokumente publike, për refuzimin e kërkesave për qasje në dokumente publike dhe për ankesat dhe mjetet juridike ndaj vendimeve për refuzimin e qasjes, vlejné përshtatshmërisht edhe për kërkesat për ripërdorimin e dokumenteve publike.</p>   | <p style="text-align: center;"><b>Article 25</b><br/><b>Application and granting access for re-use</b></p> <p>The provisions of Chapters III to V on requests for access to public documents, refusal of requests for access to public documents and on the complaints and legal remedies against the decisions rejecting the access, shall apply accordingly on requests for the re-use of public documents.</p>  | <p style="text-align: center;"><b>Član 25</b><br/><b>Zahtev i dozvoljavanja pristupa za ponovnu upotrebu</b></p> <p>Odredbe Poglavlja III do V koje se odnose na zahteve za pristup javnim dokumentima , na odbijanje zahteva za pristup javnim dokumentima i za žalbe i pravne lekove prema odlukama za odbijanje pristupa, shodno važe i za zahteve za ponovnu upotrebu javnih dokumente.</p>  |
| <p style="text-align: center;"><b>Neni 26</b><br/><b>Kushtet dhe Kufizimet për Lejimin e Ripërdorimit</b></p> <p>1. Institucionet publike bëjnë dokumentet publike të qasshme për ripërdorim në cilëndo gjuhë dhe gjendje para-ekzistuese, dhe po që se është e mundshme, në format të hapur dhe të lexueshëm nga pajisjet teknologjike, së bashku me përmbledhjet e të dhënave të tyre.</p> <p>2. Institucionet publike nuk janë të detyruara që të transformojnë formatin e informatave ose të vazhdojnë të krijojnë, përditësojnë informatat, vetëm me qëllim të ripërdorimit të tyre.</p> <p>3. Dokumentet publike, në të cilat bibliotekat, përfshirë bibliotekat universitare, muzetë dhe</p> | <p style="text-align: center;"><b>Article 26</b><br/><b>Conditions and Limitations for allowing re-use</b></p> <p>1. Public institutions shall make public documents accessible for re-use in any language and pre-existing condition and, if possible, in an open and readable format by technological equipment, together with their data summaries.</p> <p>2. Public institutions are not obliged to transform the information format or to continue to create, update the information, solely for the purpose of their re-use.</p> <p>3. Public documents, in which libraries, including university libraries, museums and</p> | <p style="text-align: center;"><b>Član 26</b><br/><b>Uslovi i ograničenja za dozvoljavanje ponovne upotrebe</b></p> <p>1. Javne institucije čine javne dokumente dostupnim za ponovnu upotrebu na bilo kom jeziku i predstojećem stanju, i ukoliko je moguće, u otvorenom formatu, čitljivom od strane tehnoloških uređaja, zajedno sa sažecima njihovih podataka.</p> <p>2. Javne institucije nisu u obavezi da transformišu format informacija ili da nastave da stvaraju, ažuriraju informacije, isključivo u cilju njihove ponovne upotrebe.</p> <p>3. Za javne dokumente, na koje biblioteke, uključujući univerzitetske biblioteke, muzeje</p> |



|  |   |  |
|--|---|--|
| <p>arkivat, kanë të drejta të pronësisë intelektuale, lejohen për ripërdorim për qëllime komerciale dhe jokomerciale vetëm në rast se ripërdorimi i dokumenteve të tilla është i lejueshëm.</p> <p>4. Institucionet publike ndalohen të bëjnë marrëveshje, të cilat lejojnë qasje për ripërdorim në baza ekskluzive. E drejta për ripërdorim duhet të jetë e hapur për të gjithë pjesëmarrësit potencialë në treg dhe ndalohet diskriminimi ndaj palëve të interesuara në qasjen për ripërdorim të dokumenteve publike.</p> <p>5. E drejta për ripërdorim nuk mund të aprovohet për dokumente publike për të cilat palët e treta mbajnë të drejta të pronësisë intelektuale.</p> <p><b>KAPITULLI VIII<br/>ORGANI I PAVARUR PËR<br/>MBIKËQYRJE TË QASJES NË<br/>DOKUMENTE DHE INFORMACIONE<br/>PUBLIKE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 27<br/>Komisioneri</b></p> <p>Komisioneri është organ në kuadër të Agjencisë, kompetent për mbikëqyrjen dhe sigurimin e zbatimit të këtij Ligji, për ndërmarrjen dhe shqiptimin e masave të</p> | <p>archives, have intellectual property rights, are permitted for re-use for commercial and non-commercial purposes, only if the re-use of such documents is permitted.</p> <p>4. Public institutions shall be prohibited from making deals, which allow access for re-use on an exclusive basis. The right to re-use should be open to all potential market participants and prohibit discrimination against stakeholders in access to re-use of public documents.</p> <p>5. The right to re-use cannot be approved for public documents on which third parties hold intellectual property rights.</p> <p><b>CHAPTER VIII<br/>INDEPENDENT BODY FOR<br/>OVERSIGHT OF ACCESS TO PUBLIC<br/>DOCUMENTS AND INFORMATION</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 27<br/>Commissioner</b></p> <p>The Commissioner is a body within the Agency, responsible for overseeing and ensuring the implementation of this Law, for undertaking and imposing measures provided</p> | <p>i arhive, imaju prava intelektualne svojine, dozvoljena je ponovna upotreba u komercijalne i nekomercijalne svrhe samo ukoliko se dozvoljava ponovna upotreba takvih dokumenata.</p> <p>4. Javnim institucijama je zabranjeno sklapanje sporazuma, koji omogućavaju pristup za ponovnu upotrebu na ekskluzivnoj osnovi. Pravo na ponovnu upotrebu treba da bude otvoreno za sve potencijalne učesnike na tržištu i zabranjuje se diskriminacija zainteresovanih strana na pristup ponovnoj upotrebi javnih dokumenata.</p> <p>5. Pravo na ponovnu upotrebu ne može se odobriti za javne dokumente za koje treća lica imaju prava intelektualne svojine.</p> <p><b>POGLAVLJE VIII<br/>NEZAVISNI ORGAN ZA NADZOR<br/>PRISTUPA JAVNIM DOKUMENTIMA I<br/>INFORMACIJAMA</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 27<br/>Poverenik</b></p> <p>Poverenik je organ u okviru Agencije, koji je odgovoran za nadzor i osiguranje sprovođenja ovog zakona, za preduzimanje i izricanje mera koje su predviđene ovom zakonom, kao</p> |
|--|---|--|

|  |   |   |
|--|---|---|
| <p>parapara me këtë ligj, si dhe për promovimin dhe trajnimin e institucioneve publike në zbatimin e këtij ligji.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 28</b><br/><b>Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komisionerit</b></p> <p>1. Si shtesë e detyrave dhe përgjegjësisve të tjera të parashikuara me këtë Ligj dhe ligje të tjera, Komisioneri ka edhe detyrat dhe përgjegjësitë në vijim:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Të monitorojë dhe raportojë në lidhje me përputhshmërinë dhe respektimin e këtij Ligji nga institucionet publike;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. Të rekomandojë ndryshime dhe reforma të natyrës së përgjithshme, por edhe specifike, të drejtuara një institucioni specifik në lidhje me të drejtën për qasje në dokumente publike;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. Të bashkëpunojë dhe të organizojë e mbajë trajnime për institucionet publike dhe zyrtarët publikë për qasje në dokumente publike në lidhje me të drejtën për qasje në dokumente publike dhe për zbatimin efektiv të këtij Ligji;</p> | <p>for by this Law and responsible for promotion and training of public institutions in the implementation of this Law.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 28</b><br/><b>Duties and Responsibilities of the Commissioner</b></p> <p>1. In addition to other duties and responsibilities provided for by this Law and other laws, the Commissioner has the following duties and responsibilities as well:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Monitor and report in relation to compliance and adherence of this Law by public institutions;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. Recommend changes and general and specific reforms addressed to a specific institution, in relation to the right of access to public documents;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. Cooperate, organize and hold meetings for public institutions and officials on access to public documents, in relation to the right to access public documents and effective implementation of this Law;</p> | <p>i za promovisanje i obučavanje javnih institucija radi sprovođenja ovog zakona.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 28</b><br/><b>Obaveze i odgovornosti Poverenika</b></p> <p>1. Pored ostalih obaveza i odgovornosti koja su predviđena ovim zakonom i drugim zakonima, Poverenik takođe ima sledeće obaveze i odgovornosti:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Da nadzire i izveštava u vezi usklađenosti i poštovanja ovog zakona od strane javnih institucija;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. Da preporučuje izmene i reforme opšte ali i specifične prirode, usmerene na specifičnu instituciju u vezi sa pravom na pristup javnim dokumentima ;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. Da sarađuje i organizuje i održava obuke za javne institucije i javna službena lica za pristup javnim dokumentima u vezi sa pravom na pristup javnim dokumentima i efikasnim sprovođenjem ovog zakona;</p> |
|--|---|---|

|   |   |   |
|---|---|---|
| <p>1.4. Të publikojë detyrimet e institucioneve publike që rrjedhin nga ky ligj dhe të drejtat e secilit person të parashikuar me këtë Ligj;</p> <p>1.5. Të ndërmarrë dhe shqiptojë ndonjëren nga masat e parashikuara me këtë ligj për zbatimin efektiv të këtij Ligji.</p> <p>2. Komisioneri është gjithashtu kompetent që të inicoj procedurën për deklasifikimin e dokumenteve të klasifikuara sipas ligjit përkatës për klasifikimin e dokumenteve.</p> <p>3. Komisioneri përgatitë një raport gjithëpërfshirës, jo më larg se data 31 mars e vitit vijues, për vitin paraprak, në lidhje me zbatimin dhe respektimin e këtij ligji nga institucionet publike dhe të njëjtin ia paraqet Kuvendit të Kosovës.</p> <p>4. Komisioneri mund të përgatisë raporte periodike dhe tematike për Kuvendin e Kosovës, publikun, institucionet publike, në lidhje me çështjet me rëndësi për të drejtën për qasje në dokumente publike.</p> | <p>1.4. Publish the obligations of public institutions deriving from this Law and the rights of each person provided for by this Law;</p> <p>1.5. Undertake and impose any of the measures stipulated in this Law for the effective implementation of the Law.</p> <p>2. The Commissioner is also competent to initiate the procedure for the declassification of classified documents based on the applicable law on classification of documents.</p> <p>3. The Commissioner shall draft a comprehensive report, not later than 31 March of the following year for the previous year, regarding the implementation and adherence of this law by public institutions, and submit it to the Assembly of Kosovo.</p> <p>4. The Commissioner may prepare periodic and thematic reports for the Assembly of Kosovo, the general public and public institutions, with regard to issues of relevance for the right of access to public documents.</p> | <p>1.4. Da objavljuje obaveze javnih institucija koje proizlaze iz ovog zakona i prava svakog lica predviđena ovim zakonom;</p> <p>1.5. Da preduzima i izriče neku od mera predviđenih ovim zakonom za efikasno sprovođenje ovog zakona.</p> <p>2. Poverenik je takođe nadležan da pokrene postupak za deklasifikacije dokumenata klasifikovanih prema odgovarajućem zakonu o klasifikaciju dokumenata.</p> <p>3. Poverenik priprema sveobuhvatni izveštaj, najkasnije do 31. marta naredne godine, za prethodnu godinu, u vezi sa sprovođenjem i poštovanjem ovog zakona od strane javnih institucija i isti podnosi Skupštini Kosova.</p> <p>4. Poverenik može pripremiti periodične i tematske izveštaje za Skupštinu Kosova, javnost, javne institucije, u vezi sa pitanjima od značaja za pravo pristupa javnim dokumentima i informacijama.</p> |
|---|---|---|

| <b>KAPITULLI IX<br/>MASAT PËR ZBATIMIN E LIGJIT</b>   | <b>CHAPTER IX<br/>MEASURES FOR IMPLEMENTING<br/>THE LAW</b>  | <b>POGLAVLJE IX<br/>MERE ZA SPROVOĐENJE ZAKONA</b>   |
|---|--|--|
| <p style="text-align: center;"><b>Neni 29<br/>Informimi dhe Trajnimi për Institucionet Publike</b></p>  | <p style="text-align: center;"><b>Article 29<br/>Information and Training for Public Institutions</b></p>  | <p style="text-align: center;"><b>Član 29<br/>Informisanje i obuka za javne institucije</b></p>  |
| <p>1. Komisioneri harton, sa më shpejt që është praktikë, një udhëzues të thjeshtë dhe të qartë në secilën prej gjuhëve zyrtare dhe në përdorim në Republikën e Kosovës, i cili përmbanë informata praktikë për lehtësimin e ushtrimit të të drejtave të parashikuara me këtë ligj. Udhëzuesi publikohet dhe shpërndahet te të gjithë institucionet publike dhe do të bëhet i qasshëm për publikun e gjerë.</p> | <p>1. The Commissioner shall draft, as soon as practicable, a simple and clear instruction, in each of the official languages and languages in use in the Republic of Kosovo, which will contain practical information on facilitating the exercise of rights provided for by this Law. The instruction shall be published and disseminated to all public institutions and will become accessible to the general public.</p> | <p>1. Poverenik izrađuje, što je pre moguće, jednostavan i jasan vodič na svakom od službenih jezika i u upotrebi u Republici Kosovo, koji sadrži praktične informacije o olakšavanju ostvarivanja prava predviđenih ovim zakonom. Vodič se objavljuje i distribuira svim javnim institucijama i biće dostupan široj javnosti.</p> |
| <p>2. Komisioneri organizon dhe mbanë konferenca, seminare dhe trajnime për zyrtarët publikë përgjegjës, shoqërinë civile dhe publikun e gjerë për të promovuar dhe lehtësuar qasjen në dokumente publike.</p>  | <p>2. The Commissioner shall organize and hold conferences, seminars and trainings for responsible public officers, civil society and the general public to promote and facilitate access to public documents.</p>   | <p>2. Poverenik organizuje i održava konferencije, seminare i obuke za odgovorna javna službena lica, civilno društvo i javnost kako bi promovisao i olakšao pristup javnim dokumentima ,</p>  |
| <p>3. Komisioneri informon institucionet publike me zhvillimet e fundit dhe praktikat më të mira për qasje në dokumente publike.</p>  | <p>3. The Commissioner shall inform public institutions of recent developments and best practices on access to public documents.</p>   | <p>3. Poverenik informiše javne institucije o najnovijim dostignućima i najboljim praksama za pristup javnim dokumentima.</p>  |

| <p align="center"><b>Neni 30</b><br/><b>Informimi dhe Vetëdijësimi i Publikut</b></p>   | <p align="center"><b>Article 30</b><br/><b>Public information and awareness</b></p>   | <p align="center"><b>Član 30</b><br/><b>Informisanje i podizanje javne svesti</b></p>  |
|---|---|--|
| <p>1. Institucionet publike informojnë publikun për të drejtën për qasje në dokumente publike dhe për mënyrën në të cilën kjo e drejtë mund të ushtrohet.</p> <p>2. Institucionet publike ndërmarrin masat e nevojshme për të:</p> <p>1.1. Përbushur detyrat dhe obligimet e tyre lidhur me zbatimin e kësaj të drejte;</p> <p>1.2. Ofruar informata mbi çështje apo aktivitetet, për të cilat janë përgjegjëse;</p> <p>1.3. Menaxhuar dokumentet e tyre publike në mënyrë efikase, në mënyrë që të ketë qasje të lehtë;</p> <p>1.4. Informuar publikun për të drejtat, të cilat rrjedhin nga ky ligj; si dhe</p> <p>1.5. Caktuar njësinë apo zyrtarin përgjegjës për komunikim me qytetarë, e/i cila/i është përgjegjës/e për pranimin dhe shqyrtimin fillestar të kërkesave për qasje në dokumente.</p> | <p>1. Public institutions shall inform the public of their rights to access public documents and the manner how this right can be exercised.</p> <p>2. The public institutions shall take the necessary measures to:</p> <p>1.1. fulfil their duties and obligations regarding the implementation of this right;</p> <p>1.2. provide information on issues or activities related to their responsibilities;</p> <p>1.3. manage their public documents, efficiently, so that they are easily accessible;</p> <p>1.4. inform the public about the rights arising from this Law; and</p> <p>1.5. Determine the unit or responsible officer for communication with citizens, who shall be responsible for receiving and conducting an initial review of applications for access to documents.</p> | <p>1. Javne institucije informišu javnost o pravu pristupa službenim dokumentima i o načinu na koji se to pravo može ostvariti.</p> <p>2. Javne institucije preduzimaju potrebne mere da:</p> <p>1.1. Ispune svoje dužnosti i obaveze u vezi sa sprovođenjem ovog prava;</p> <p>1.2. Pružaju informacije o pitanjima ili aktivnostima, za koje su odgovorne;</p> <p>1.3. Upravljaju svojim javnim dokumentima na efikasan način, kako bi imali lak pristup;</p> <p>1.4. Informišu javnost o pravima, koja proističu iz ovog zakona; kao i</p> <p>1.5. Određuju jedinicu ili službeno lice odgovorno za komunikaciju sa građanima, koja/i je odgovorna/an za prijem i početno razmatranje zahteva za pristup dokumentima.</p> |

| <p align="center"><b>Neni 31<br/>Raportimi</b></p>   | <p align="center"><b>Article 31<br/>Reporting</b></p>   | <p align="center"><b>Član 31<br/>Izveštavanje</b></p>  |
|--|---|--|
| <p>1. Për të siguruar transparencë të plotë në punën e tyre edhe sa i përket qasjes në dokumente publike, institucionet publike, përmes zyrtarit përgjegjës për qasje në dokumente publike, hartojnë një raport vjetor më së largu deri në fund të muajit janar të vitit actual, për periudhën deri në datën 31 dhjetor të vitit paraprak, ku përfshihet numri i rasteve, në të cilat, institucioni publik ka lejuar qasjen, numrin e rasteve në të cilat institucioni publik ka refuzuar qasjen në dokumente, si dhe arsyet e këtyre refuzimeve.</p> <p>2. Secili institucion publik, raportin vjetor për vitin paraprak, ia dërgon Komisionerit.</p> <p>3. Komisioneri përgatitë raportin gjithëpërfshirës për vitin paraprak deri në fund të muajit mars të vitit actual, për periudhën deri në datën 31 dhjetor të vitit të kaluar.</p> <p>4. Komisioneri ia dorëzon një kopje të raportit gjithëpërfshirës Kuvendit të Kosovës, së bashku me rekomandimet për masat dhe ndryshimet që kanë për synim të rrisin transparencën dhe qasjen e publikut në</p> | <p>1. In order to provide full transparency with regard to their work and access to public documents, the public institutions shall, through the official responsible for access to public documents, draft an annual report at the latest by the end of January of the current year for the period until 31 December of the previous year, including the number of cases in which the public institution has granted access to documents, the number of cases in which the public institution denied access to documents, as well as reasons for such refusals.</p> <p>2. Each public institution shall send the annual report on the previous year to the Commissioner.</p> <p>3. The Commissioner shall prepare a comprehensive report for the preceding year by the end of March of the current year for the period until 31 December of the previous year.</p> <p>4. The Commissioner shall submit a copy of the comprehensive report to the Assembly of Kosovo, together with other recommendations for measures and amendments aiming to increase transparency</p> | <p>1. Da bi se osigurala potpuna transparentnost u njihovom radu u pogledu pristupa javnim dokumentima, javne institucije, putem službenog lica odgovornog za pristup javnim dokumentima sastavljaju godišnji izveštaj najkasnije do kraja januara tekuće godine, za period do 31. decembra prethodne godine, uključujući broj slučajeva, u kojima je javna institucija dozvolila pristup, broj slučajeva u kojima je javna ustanova odbila pristup dokumentima kao i razloge za ova odbijanja.</p> <p>2. Svaka javna institucija, godišnji izveštaj za prethodnu godinu, šalje Povereniku.</p> <p>3. Poverenik priprema sveobuhvatni izveštaj za prethodnu godinu do kraja marta tekuće godine, za period do 31. decembra prethodne godine.</p> <p>4. Poverenik dostavlja kopiju sveobuhvatnog izveštaja Skupštini Kosova, zajedno sa preporukama o merama i izmenama koje imaju za cilj povećanje transparentnosti i pristupa javnosti javnim dokumentima,</p> |

|   |   |  |
|---|---|--|
| <p>dokumente publike, duke përfshirë, nëse është nevoja, propozimet për rishikimin e këtij ligji.</p> <p>5. Komisioneri nxjerr akt nënligjor për mënyrën e mbajtjes së evidencës dhe raportimit për zbatimin e këtij Ligji.</p> <p><b>KAPITULLI X<br/>GJOBAT</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 32<br/>Autoriteti Kompetent për Shqiptimin e Gjobave</b></p> <p>1. Agjencia është kompetente për shqiptimin e gjobave ndaj institucioneve publike dhe zyrtarëve përgjegjës, sipas dispozitave të këtij Ligji.</p> <p>2. Mjetet finaciare të mbledhura nga shqiptimi i gjobave sipas këtij neni dhe nenit 32 të këtij ligji, derdhen në buxhetin e Republikës së Kosovës.</p> <p>3. Para shqiptimit të ndonjëres prej gjobave të parashikuara me nenin 32 të këtij Ligji, Agjencia informon institucionin publik me qëllimin dhe arsyen për shqiptimin e gjobës dhe i ofron një afat kohor, jo më të gjatë se shtatë (7) ditë, për të përmirësuar shkeljen e</p> | <p>and public access to public documents, including, if necessary, proposals for review of this Law.</p> <p>5. The Commissioner shall issue a sub-legal act on the manner of keeping evidences and reporting on the implementation of this Law.</p> <p><b>CHAPTER X<br/>FINES</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 32<br/>Competent Authority for the Imposition of Fines</b></p> <p>1. The Agency is competent to impose fines against public institutions and responsible officers, in accordance with the provisions of this Law.</p> <p>2. The funds collected from the imposition of fines under this Article and Article 32 of this Law shall go to the budget of the Republic of Kosovo.</p> <p>3. Prior to imposing any of the fines provided under Article 32 of this Law, the Agency shall inform the public institution of the purpose and the reason for imposing the fine and shall provide a time limit of not less than seven (7) days to remedy the identified</p> | <p>uključujući, ukoliko je to potrebno, predloge za reviziju ovog zakona.</p> <p>5. Poverenik izdaje podzakonski akt o načinu vođenja evidencije i izveštavanja o sprovođenju ovog zakona.</p> <p><b>POGLAVLJE X<br/>NOVČANE KAZNE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 32<br/>Nadležni organ za izricanje novčanih kazni</b></p> <p>1. Agencija je nadležan za izricanje i novčanih kazni izrečenih javnim institucijama i odgovornim službenim licima, u skladu sa odredbama ovog zakona.</p> <p>2. Finansijska sredstva prikupljena od izricanja novčanih kazni u skladu sa ovim članom i članom 32. ovog zakona, deponuju se u budžet Republike Kosovo.</p> <p>3. Pre izricanja bilo koje od novčanih kazni predviđenih članom 32. ovog zakona, Agencija obaveštava javnu instituciju o cilju i razlogu za izricanje novčane kazne i nudi vremenski rok, od najviše sedam (7) dana, radi ispravljanja evidentiranog prekršaja,</p> |
|---|---|--|

|  |  |   |
|--|--|---|
| <p>evidentuar, në mënyrë që të mos shqiptohet gjoba.</p> <p>4. Në procedurën për shqiptimin e gjobave sipas këtij Ligji, Agjencia vepron në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës që rregullon procedurën për shqiptimin e gjobave nga Agjencia.</p> <p>5. Në rast se institucioni publik nuk përmirëson shkeljen e evidentuar sipas udhëzimeve të Agjencisë, kjo e fundit merr vendim për shqiptimin e gjobës.</p>  | <p>violation, so that the fine is not imposed.</p> <p>4. In the procedure for imposing fines under this Law, the Agency shall act in accordance with the provisions of the relevant law governing the procedure for imposing fines by the Agency.</p> <p>5. In case the public institution does not improve the identified violation according to the instructions of the Agency, the latter shall make a decision to impose the fine.</p>   | <p>kako ne bi došlo do izricanja novčane kazne.</p> <p>4. U postupku za izricanje novčanih kazni u skladu sa ovim zakonom, Agencija postupa u skladu sa odredbama odgovarajućeg zakona kojim se reguliše postupak izricanja novčanih kazni od strane Agencije.</p> <p>5. U slučaju da javna institucija ne ispravi utvrđenu povredu prema uputstvima Agencije, ista će doneti odluku o izricanju novčane kazne.</p>   |
| <p style="text-align: center;"><b>Neni 33</b><br/><b>Arsyet për Shqiptimin e Gjobave dhe Lartësia e Tyre</b></p> <p>1. Institucioni publik, i cili në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, e pamundëson, pengon ose kufizon realizimin e të drejtave për qasje në dokumente publike, dënohet me gjobë prej tre mijë (3,000) deri në dhjetëmijë (10,000) €.</p> <p>2. Me gjobë prej njëmijë (1,000) deri në tremijë (3,000) €, ndëshkohet për kundërvajtje institucioni publik, i cili lejon dëmtimin, shkatërrimin, fshehjen ose në ndonjë mënyrë ose formë tjetër e bënë të paqartë dokumentin publik, me qëllim të</p> | <p style="text-align: center;"><b>Article 33</b><br/><b>Reasons for Imposing Fines and their Amount</b></p> <p>1. The public institution which in contradiction to the provisions of this Law, disables, hinders or restricts the realization of the right of access to public documents, shall be fined from three thousand (3,000) to ten thousand (10,000) €.</p> <p>2. The public institutions that allows the damaging, destruction, concealing, or in any way or form makes the public document, unclear, with the purpose of disallowing the realization of the right of access to the public</p> | <p style="text-align: center;"><b>Član 33</b><br/><b>Razlozi za izricanje novčanih kazni i njihova visina</b></p> <p>1. Javna institucija, koja u suprotnosti sa odredbama ovog zakona, onemogućava, ometa ili ograničava ostvarivanje prava na pristup javnim dokumentima, kažnjava se novčanom kaznom od tri hiljade (3.000) do deset hiljade (10.000) €.</p> <p>2. Novčanom kaznom od hiljadu (1,000) do tri hiljade (3.000) €, kažnjava se za prekršaj javna institucija, koja dozvoli oštećenje, uništenje, sakrivanje ili na neki drugi način čini javni dokument nejasnim, u cilju</p> |



|  |  |   |
|--|--|---|
| <p>pamundësimit të realizimit të së drejtës në qasje të dokumenteve publike, nga ana e kërkesit të interesuar.</p> <p>3. Për kundërvajtje nga paragrafi 2 i këtij neni, me gjobë prej pesëqind (500) deri një mijë (1,000) €, ndëshkohet zyrtari përgjegjës i institucionit publik kompetent.</p> <p>4. Me gjobë prej një mijë (1,000) deri në tremijë (3,000) €, ndëshkohet institucioni publik, i cili nuk përgjigjet fare në kërkesën për qasje në dokumente publike.</p> | <p>document by the interested party, shall be given a fine from one-thousand (€1,000) to three-thousand (€3,000) euros.</p> <p>3. The responsible official of the competent public institutions shall be given a fine from five hundred (500) to one thousand (1,000) €, for an offence under paragraph 2 of this Article.</p> <p>4. The public institution that fails to respond to the request for access to public documents shall be given a fine from one thousand (1,000) to three thousand (3,000) €.</p> | <p>onemogućavanja ostvarivanja prava na pristup javnim dokumentima, od strane zainteresovanog podnosioca zahteva.</p> <p>3. Za prekršaje iz stava 2. ovog člana, novčanom kaznom u iznosu od pet stotina (500) do hiljadu (1.000) €, kažnjava se odgovorno službeno lice u nadležnoj javnoj instituciji,</p> <p>4. Novčanom kaznom od hiljadu (1,000) do tri hiljade (3.000) €, kažnjava se javna institucija, koja uopšte ne odgovori na zahtev za pristup javnim dokumentima.</p> |
| <p><b>KAPITULLI XI</b><br/><b>DISPOZITAT KALIMTARE DHE</b><br/><b>PËRFUNDIMTARE</b></p>  | <p><b>CHAPTER XI</b><br/><b>TRANSITIONAL AND FINAL</b><br/><b>PROVISIONS</b></p>   | <p><b>POGLAVLJE XI</b><br/><b>PRELAZNE I ZAVRŠNE ODREDBE</b></p>  |
| <p><b>Neni 34</b><br/><b>Nxjerrja e Akteve Nënligjore</b></p>  | <p><b>Article 34</b><br/><b>Issuance of sub-legal acts</b></p>   | <p><b>Član 34</b><br/><b>Donošenje podzakonskih akata</b></p>   |
| <p>1. Me propozim të Agjencisë Qeveria miraton akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji, më së largu një (1) vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.</p> <p>2. Mos përgatitja e akteve nënligjore, sipas paragrafit paraprak, nuk i lejon institucionet të refuzojnë qasjen në dokumente publike.</p>   | <p>1. Upon the proposal of the Agency, the Government shall approve the sub-legal acts for the implementation of this Law, at the latest one (1) year after the entry into force of this Law.</p> <p>2. The failure to draft sub-legal acts, according to the previous paragraph, shall not allow institutions to refuse access to public documents.</p>   | <p>1. Na predlog Agencije, Vlada usvaja podzakonske akte za sprovođenje ovog zakona, ne kasnije od jedne (1) godine nakon stupanja na snagu ovog zakona</p> <p>2. Nepripremanje podzakonskih akata, prema prethodnom stavu, ne dozvoljava se institucijama da odbiju pristup javnim dokumentima.</p>  |

|   |  |  |
|---|--|--|
| <p style="text-align: center;"><b>Neni 35<br/>Shfuqizimi</b></p> <p>1. Ky ligj shfuqizon:</p> <p>1.1. Ligjin Nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike.</p> <p>1.2. Me kusht që të mos jenë në kundërshtim me këtë Ligj, aktet nënligjore të nxjerra në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike vazhdojnë të zbatohen deri në nxjerrjen e akteve të reja në pajtim me këtë Ligj.</p> | <p style="text-align: center;"><b>Article 35<br/>Abrogation</b></p> <p>1. The present Law shall abrogate:</p> <p>1.1. Law No. 03/L-215 on Access to Public Documents.</p> <p>1.2. Provided that they are not in contradiction with this Law, the sub-legal acts issued in accordance with Law No. 03/L-215 on Access to Public Documents shall continue to apply until the issuance of new acts in accordance with this Law.</p> | <p style="text-align: center;"><b>Član 35<br/>Stavljanje van snage</b></p> <p>1. Ovaj zakon stavlja van snage:</p> <p>1.1. Zakon Br. 03/L-215 o uvidu u javnim dokumentima.</p> <p>1.2. Pod uslovom da nisu u suprotnosti sa ovim Zakonom, podzakonski akti doneti u skladu sa Zakon Br. 03/L-215 o pristupu javnim dokumentima se i dalje primenjuju do donošenja novih akata u skladu sa ovim Zakonom.</p> |
| <p style="text-align: center;"><b>Neni 36<br/>Hyrja në Fuqi</b></p> <p>Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.</p> <p style="text-align: right;">Kadri Veseli</p> <hr style="width: 20%; margin-left: auto; margin-right: 0;"/> <p>Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës</p>  | <p style="text-align: center;"><b>Article 36<br/>Entry into force</b></p> <p>This Law shall enter into force fifteen (15) days after the publication in Official Gazette of the Republic of Kosovo.</p> <p style="text-align: right;">Kadri Veseli</p> <hr style="width: 20%; margin-left: auto; margin-right: 0;"/> <p>The President of the Assembly of the Republic of Kosovo.</p>   | <p style="text-align: center;"><b>Član 36<br/>Stupanje na snagu</b></p> <p>Ovaj zakon stupa na snagu petnaest (15) dana od dana objavljivanja u Službenom listu Republike Kosovo.</p> <p style="text-align: right;">Kadri Veseli</p> <hr style="width: 20%; margin-left: auto; margin-right: 0;"/> <p>Predsednik Skupštine Republike Kosovo</p>  |